

KODI I SJELLJES



BNP PARIBAS

The bank
for a changing
world

PARATHËNIE



JEAN LEMIERRE

Kryetari i Bordit të Drejtorëve

JEAN-LAURENT BONNAFÉ

Kryeshef Ekzekutiv



Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i Përgjithshëm i BNP Paribas ndajnë bindjen se suksesi i Bankës varet drejtpërdrejt nga sjellja e çdo punonjësi. Së bashku, ne jemi të përkushtuar që të ndërtojmë të ardhmen e BNP Paribas mbi bazat e ekspertizës dhe integritetit profesional.

Kjo kërkon sigurimin e angazhimit të të gjithë punonjësve në të gjithë Grupin dhe fitimin e besimit të partnerëve tanë, klientëve dhe aksionarëve, si dhe rregullatorëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile në çdo vend ku Banka bën biznes.

Për ta bërë këtë, sigurisht që duhet të respektojmë në përpikëri ligjet dhe rregulloret. Në të njëjtën kohë, ne duhet të shkojmë më tej dhe të sigurohemi që çdo vendim të udhëhiqet nga një ndjenjë e thellë e përgjegjësisë etike. Kjo fillon me respektimin e politikave dhe procedurave të Grupit dhe një aftësi për të identifikuar, për ta përshkallëzuar menjëherë dhe për të mësuar nga praktikatat joadekuate.

Bota në të cilën funksionon Banka vazhdon të ndryshojë me një ritëm të përshpejtuar. BNP Paribas mund t'i menaxhojë këto ndryshime duke i parashikuar ato, duke u përshtatur dhe duke u përditësuar dhe kjo falë një kulture korporative të mishëruar nga vlerat e forta që zbatohen pa kompromis.

Kjo frymë ka formësuar Kodin tonë të Sjelljes, i cili përcakton rregullat që drejtojnë të gjitha veprimet tona, në përputhje me vlerat tona thelbësore. Ky Kod i Sjelljes udhëzon të menduarit dhe sjelljen tonë. Ai shpreh atë që ne aspirojmë të jemi: një nga bankat më të respektuara evropiane me shtrirje globale dhe një lider në financat e qëndrueshme.

Kodi i Sjelljes është një udhëzues për veprimet dhe vendimet tona. Rregullat e Sjelljes duhet të ndiqen rreptësisht nga të gjithë punonjësit. Nuk ka rregulla specifike që mund të zbatohen për çdo situatë. Përkundrazi, Kodi i Sjelljes duhet të mishërohet mjaftueshëm për të siguruar që, i ndihmuar nga politikat dhe procedurat, mbështetja e menaxhmentit dhe gjykimi personal, kjo frymë të respektohet gjithmonë.

Ne vendosim besimin tonë tek të gjithë punonjësit tanë për t'i ngërthyer plotësisht këto vlera dhe parime, të cilat mbështesin kontributin tonë në shoqëri, unitetin tonë dhe suksesin tonë.



TABELA E PËRMBAJTJES

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	06
A MISIONI DHE VLERAT	07
◆ Misioni	08
◆ Vlerat	09
B RREGULLAT E SJELLJES	11
◆ 1 Interesat e klientit	13
Kuptimi i nevojave të klientëve dhe të situatës.	13
Ofrimi i informatave të drejta, të qarta dhe jo mashtruese për klientin.	15
Sigurimi i trajtimit të drejtë të klientëve.	16
Trajtimi i ankesave të klientëve në mënyrë të duhur dhe të drejtë.	16
◆ 2 Siguria financiare	17
Lufta kundër pastrimit të parave, ryshfetit, korrupsionit dhe financimit të terrorizmit.	17
Pajtueshmëria ndaj sanksioneve dhe embargove.	18
◆ 3 Integriteti i tregut	18
Pajtueshmëria me rregullat e abuzimit të tregut dhe praktikatat e konkurrencës së ndershme në kontekstin e aktiviteteve të tregut.	18
Parandalimi dhe shmangia e konflikteve të interesave transaksionale.	20
◆ 4 Etika profesionale	20
Asnjëherë mos përdorni informatat e brendshme ose informatat e tjera konfidenciale në transaksionet personale.	20
Parandalimi dhe shmangia e konflikteve të interesave sa i përket aktiviteteve dhe interesat e jashtëm të biznesit.	21
Asnjëherë të mos shkëmbehen informatat e ndjeshme komerciale me konkurrentët dhe asnjëherë të mos koordinoheni me konkurrentët mbi politikën tregtare të Grupit.	23

TABELA E PËRMBAJTJES

5	Respekt për persona	23
	Zbatimi i standardeve më të mira të sjelljes profesionale.	23
	Refuzimi i çdo forme të diskriminimit.	24
	Garantimi i sigurisë në vendin e punës.	25
6	Mbrojtja e Grupit	26
	Ndërtimi dhe mbrojtja e vlerës afatgjatë të Grupit BNP Paribas.	26
	Mbrojtja e informatave të Grupit.	26
	Ruajtja e privatësisë individuale.	27
	Komunikimi me përgjegjësi.	29
	Veprimi në mënyrë etike me palët e jashtme.	29
	Marrja e rreziqeve me përgjegjësi duke siguruar kontroll të rreptë të rrezikut.	30
	Përgjegjshmëria pasi të largoheni nga Grupi BNP Paribas.	30
7	Përfshirja me shoqërinë	31
	Respektimi i të Drejtave të Njeriut. .	31
	Mbrojtja e mjedisit dhe luftimi i ndryshimeve klimatike.	32
	Veprimi me përgjegjësi në përfaqësimin publik.	32
	Kontributi për një shoqëri më gjithëpërfshirëse.	32
C	 KODI I SJELLJES NË PRAKTIKË	33
	Marrja e vendimeve.	34
	Si përputhet Kodi me ligjet vendore dhe ndërkombëtare?	35
	Ngritja e zërit dhe paraqitja e shqetësimeve.	36
	Përgjegjësitë dhe llogaridhënie shtesë për menaxherët.	37
D	 SHTOJCA KUNDËR KORRUPSIONIT	38
	Parandalimi, zbulimi dhe luftimi i korrupsionit dhe tregtisë së ndikuar.	38

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

“ Kodi i Sjelljes së Grupit BNP Paribas qëndron në thelb të çdo veprimi. Ai udhëzon të gjitha vendimet në të gjitha nivelet e organizatës. Si të tilla, të gjitha politikat dhe procedurat e brendshme brenda Grupit do të rishikohen dhe do të bëhen në përputhje me Kodin nëse shihet si e nevojshme.

Kodi i Sjelljes përbëhet nga tre pjesë. Seksioni i parë, mbi Misionin dhe Vlerat, synon të udhëzojë dhe frymëzojë të gjitha sjelljet. Seksioni i dytë mbulon rregullat e sjelljes për t’u zbatuar. Seksioni i tretë, i quajtur Kodi i Sjelljes në praktikë, ofron udhëzime të dobishme se si të zbatohen rregullat e sjelljes.”

A

MISIONI DHE VLERAT

MISIONI

Tregon se çfarë përfaqëson Grupi dhe cili është qëllimi i tij.

VLERAT

BNP Paribas Way (mënyra) i drejton veprimet tona. BNP Paribas Way është e organizuar rreth katër Fuqive dhe katër Forcave Drejtuese.

B

RREGULLAT E SJELLJES

Rregullat e sjelljes janë rregulla konkrete të cilat të gjithë punonjësit e Grupit BNP Paribas¹ duhet ti kuptojnë dhe ti respektojnë. Pajtueshmëria me këto rregulla është thelbësore për aftësinë tonë për të mbështetur vlerat dhe standardet tona etike, një parakusht për të vepruar në BNP Paribas Way.

C

KODI NË PRAKTIKË

Ky seksion ofron detaje se si të zbatohet Kodi i Sjelljes. Ai artikulon qartë se çfarë pritet nga çdo punonjës dhe pyetjet që secili individ duhet t’i bëjë vetes para se të marrë vendime. Gjithashtu trajton mënyrën se si Kodi përputhet me ligjet ose rregulloret vendore dhe gjithashtu lidhet me politikën tonë të Sinjalizimit. Çdo biznes do të jetë përgjegjës për përshtatjen dhe zbatimin, kur është relevante, implikimet praktike të Kodit të Sjelljes për aktivitetet e tyre përkatëse.

1 – Të gjithë personat e punësuar nga Grupi, të brendshëm dhe të jashtëm.

MISIONI DHE VLERAT

Kontributi social i Grupit BNP Paribas fillon me përgjegjësinë ekonomike për të financuar ekonominë në mënyrë etike, duke i ndihmuar klientët tanë të arrijnë planet dhe projektet e tyre. Për më tepër, Grupi është i përfshirë ngushtë në komunitetet lokale ku ai bën biznes dhe ka parasysh se ka përgjegjësi shtesë sociale, qytetare dhe mjedisore.

Për të siguruar që ndikimi i punës së punonjësve të tij të jetë pozitiv, Grupi BNP Paribas mbështet standardet më të larta të sjelljes dhe etikës në fushat e të Drejtave të Njeriut, punës, mjedisit dhe antikorrupsionit², pavarësisht nga aktivitetet e tij. Si i tillë, Grupi pranon dhe është i përkushtuar të respektojë një sërë parimesh dhe normash që mbështesin mënyrën se si bën biznes.

MISIONI

Misioni i BNP Paribas është të sigurojë financim për ekonominë dhe të këshillojë klientët në mënyrë etike, duke mbështetur projektet, investimet dhe menaxhimin e kursimeve të tyre. Misioni shpreh qartë se çfarë përfaqëson Grupi dhe qëllimin e tij³:

- ◆ ne duam të kemi një ndikim pozitiv tek akterët tanë – klientët, partnerët tregtarë, punonjësit, aksionarët – si dhe në shoqëri. Ne duam të kontribuojmë për një të ardhme më të mirë,
- ◆ ne do të ofrojmë një vend pune frymëzues dhe stimulues për kolegët tanë,

- ◆ ne duam të jemi ndër lojtarët më të besueshëm të industrisë sonë, duke mishëruar më tej Vlerat tona dhe etikën në çdo gjë që bëjmë,
- ◆ ekipet tona me përkushtim të lartë do të ofrojnë shërbime dhe zgjidhje të klasit të parë për klientët tanë përmes modelit të integruar të Grupit.

Në mjedisin e sotëm nuk mjafton vetëm respektimi i ligjeve dhe rregulloreve. Ne duam gjithashtu të tregojmë se aktivitetet e BNP Paribas kanë një ndikim pozitiv në të gjithë akterët tanë në përgjithësi, si dhe që Grupi është një kompani fitimprurëse dhe një akter i përgjegjshëm në ekonomitë të cilave u shërben.

Modeli i integruar i Grupit BNP Paribas na lejon të ofrojmë shërbimin e klasit të parë që klientët e kërkojnë dhe e meritojnë. Ruajtja e një modeli të integruar nuk ka të bëjë vetëm me diversifikimin e rreziqeve. Gjithashtu bëhet fjalë për mënyrën se si të gjithë punonjësit u shërbejnë klientëve tanë. Modeli i integruar i Grupit na mundëson të kemi një njohuri të detajuar të klientëve tanë si dhe mundësinë për të shfrytëzuar burimet e shumta dhe aftësitë e Grupit për të ofruar zgjidhjet më të mira të mundshme. Modeli i integruar na lejon të fitojmë besimin e klientëve tanë në të gjithë rruzullin çdo ditë.

Gjithashtu kemi për detyrë të jemi gjithmonë të vëmendshëm ndaj pritshmërive të punonjësve tanë, si pasuri më e vlefshme e Grupit. Është puna e tyre e palodhur dhe idetë e tyre që drejtojnë suksesin e Grupit BNP Paribas. Për të pasur sukses, punonjësit tanë duhet të punojnë në një mjedis frymëzues dhe stimulues.

Kur sjelljet e përditshme janë të mishëruara në Vlerat dhe të gjithë veprojnë me sjellje të përsosur, kjo ndërton besimin në mesin e kolegëve dhe klientëve. Ky besim është ajo që do ta veçojë Grupin BNP Paribas brenda industrisë.

Misioni i Grupit përfshin një spektër të gjerë të akterëve. Është përgjegjësi e të gjithëve që të sigurohet që Vlerat dhe rregullat tona të jenë më shumë se fjalë të thjeshta dhe t'i jetësojnë ato si në nivel personal ashtu edhe në atë kolektiv brenda Grupit BNP Paribas.

3 – Qëllimi i Grupit BNP Paribas është një tekst i bazuar në dokumentet e Misionit dhe Vizionit, Kodit të Sjelljes dhe Politikave të Angazhimit, i disponueshëm këtu: <https://group.bnpparibas/en/group/about-us/company-purpose>

VLERAT

Vlerat tona të “The BNP Paribas Way” përfaqësojnë pikëpamjen kolektive të punonjësve të Grupit BNP Paribas. Vlerat tona thelbësore u zhvilluan përmes një procesi bashkëpunues në të cilin ishin ftuar që të kontribuojnë i gjithë stafi i Grupit BNP Paribas. Të gjithë në grup duhet të udhëhiqen nga këto vlera në aktivitetet e tyre të përditshme.

Elaborimi i Vlerave u mundëson punonjësve aktualë dhe të ardhshëm të kuptojnë më mirë se çfarë pritët prej tyre dhe çfarë e bën unik Grupin BNP Paribas. Mbrotjtja e këtyre Vlerave është thelbësore për ndjekjen e strategjisë

së Grupit në transformimin dhe rritjen, duke ruajtur besimin që klientët, partnerët tregtarë, punonjësit, aksionarët dhe komuniteti më i gjerë e kanë në Bankë.

PËRPARËSITË TONA

Përparësitë janë gurë-themeli i Grupit BNP Paribas. Ato bëjnë të mundur ruajtjen e një modeli të integruar bankar dhe pozitat e ranguar më së larti në të ardhmen.

STABILITETI

Ne ndërtojmë mbi menaxhimin tonë të fuqishëm të orientuar në aspektin afatgjatë, modelin tonë të larmishëm dhe të integruar të biznesit dhe ndikimin tonë ndërkombëtar.

EKSPERTIZA

Ne ndërtojmë mbi njohurinë tonë të pranuar dhe zgjëruese të ekipeve tona.

PËRGJEGJËSIA

Ne ndërtojmë mbi kulturën tonë të përgjegjësisë dhe integritetit për t'i shërbyer gjithnjë e më mirë interesave të klientëve tanë.

VEND I MIRË PËR TË PUNUAR

Ne mbështesim një vend pune stimulues ku njerëzit trajtohen në mënyrë të drejtë dhe me respekt.

FORCAT TONA SHTYTËSE

Forcat shpytëse janë fushat në të cilat të gjithë punonjësit duhet të punojnë dhe zhvillohen vazhdimisht për të pasur sukses në sfidat e tyre përkatëse dhe për të ndihmuar në ndërtimin e së ardhmes së Grupit BNP Paribas.

SHKATHHTËSIA

Ne duam të sillemi më thjesht, për të përqaftuar inovacionin e dobishëm dhe transformimin digjital.

KËNAQËSHMËRIA E KLIENTIT

Ne besojmë se suksesi ynë qëndron në të qenit zgjedhja e preferuar e klientëve dhe konsumatorëve. Ne kërkojmë t'i dëgjojmë me kujdes dhe të punojmë ngushtë me ta.

KULTURA E PAJTUESHMËRISË

Ne besojmë në promovimin e rregullave të qarta për të nxitur një kulturë të fortë pajtueshmërisë dhe etikës.

SINQERITETI

Ne promovojmë qëndrimin mendjehapur ndaj akterëve tanë. Ne synojmë që të gjithë në Grup të ndihen të përfshirë, të kenë fjalën e tyre dhe të fuqizohen.

ÇFARË NA DUHET PËR TË ARRITUR ATY

Për të jetuar sipas vlerave tona dhe për të arritur misionin tonë, ne duhet të jemi të përgatitur për të bërë zgjedhje dhe vendime të guximshme. Grupi është i përkushtuar të përmirësohet vazhdimisht:

SI BËJMË BIZNES

- ◆ Trajtoni nevojat e klientëve në mënyrë transparente, të ndershme, të hapur dhe të përgjegjshme, duke promovuar konkurrencë të hapur dhe të ndershme me standardet më të larta të pajtueshmërisë dhe etikës.
- ◆ Ndërtoni kolektivisht mbi ekspertizën tonë për të arritur ekselencë në bizneset ku kemi zgjedhur të operojmë.
- ◆ Merrni parasysh pasojat e veprimeve tona në shoqërinë e gjerë.

SI KRYHET PUNA

- ◆ Nxitja e inovacionit digjital dhe të dobishëm.
- ◆ Thjeshtëzimi i mëtejshëm i mënyrës së punës për të fituar shkathtësi.
- ◆ Lejoni njerëzit të eksperimentojnë me një qasje testo-dhe-mëso.
- ◆ Besoni dhe fuqizoni njerëzit që të përqafojnë mundësitë e biznesit dhe zhvillimin e klientëve brenda një kornize të qartë.
- ◆ Merrni vendime në të gjitha nivelet e organizatës dhe jini përgjegjës për veprimet.

SI KUJDESEMI PËR NJERËZIT

- ◆ Promovojmë diversitet në mënyrë aktive.
- ◆ Inkurajojmë lëvizshmërinë për të ofruar përvoja të larmishme.
- ◆ Zhvillojmë talentet dhe vazhdojmë të investojmë në pasurinë kryesore të Grupit: njerëzit tanë.

RREGULLAT E SJELLJES

Për të jetuar sipas vlerave tona – BNP Paribas Way – ne duhet të respektojmë rregullat. Në këtë dokument do të gjeni një artikulum të qartë të sjelljeve të pranueshme dhe të papranueshme. Respektimi i këtyre rregullave është thelbësor për aftësinë tonë për të mbështetur vlerat dhe standardet tona etike, një parakusht për të vepruar me mënyrën BNP Paribas Way. Grupi do të ketë zero tolerancë në lidhje me mosrespektimin e qëllimshëm të këtyre rregullave.

Rregullat janë të organizuara në shtatë temat në vijim.

TEMAT E SJELLJES	VLERAT PËRPARËSITË DHE FORCA SHTYTËSE	RREGULLAT E SJELLJES
1 INTERESAT E KLIENTIT	EKSPERTIZA	- Kuptimi i nevojave të klientëve dhe të situatës. - Ofrimi i informatave të drejta, të qarta dhe jo mashtruese për klientin. - Sigurimi i trajtimit të drejtë të klientëve. - Trajtimi i ankesave të klientëve në mënyrë të duhur dhe të drejtë.
2 SIGURIA FINANCIARE	- KËNAQËSHMËRIA E KLIENTIT	- Lufta kundër pastrimit të parave, ryshfetit, korrupsionit dhe financimit të terrorizmit. - Pajtueshmëria ndaj sanksioneve dhe embargoeve.
3 INTEGRITETI I TREGUT	- PËRGJEGJËSIA	- Pajtueshmëria me Rregullat e Abuzimit të Tregut dhe praktikat e konkurrencës së ndershme në kontekstin e aktiviteteve të tregut. - Parandalimi dhe shmangia e konflikteve të interesave transaksionale.
4 ETIKA PROFESIONALE	- KULTURA E PAJTUESHMËRISË	- Asnjëherë mos përdorni informatat e brendshme ose informatat e tjera konfidenciale në transaksionet personale. - Parandalimi dhe shmangia e konflikteve të interesit në aktivitete urdhëresa/mandate dhe interesa të jashtme të biznesit. - Asnjëherë të mos shkëmbehen informatat e ndjeshme komerciale me konkurrentët dhe asnjëherë të mos koordinoheni me konkurrentët mbi politikën tregtare të Grupit.
5 RESPEKT PËR PERSONAT	VEND I MIRË PËR TË PUNUAR - SINQERITETI	- Zbatimi i standardeve më të mira të sjelljes profesionale. - Refuzimi i çdo forme të diskriminimit. - Garantimi i sigurisë në vendin e punës.
6 MBROJTJA E GRUPIT	STABILITETI - SHKATHTËSIA	- Ndërtimi dhe mbrojtja e vlerës afatgjatë të Grupit BNP Paribas. - Mbrojtja e informatave të Grupit. - Ruajtja e privatësisë individuale. - Komunikimi me përgjegjësi. - Veprimi në mënyrë etike me palët e jashtme. - Marrja e rreziqeve me përgjegjësi duke siguruar kontroll të rreptë të rrezikut. - Përgjegjshmëria pasi të largoheni nga Grupi BNP Paribas.
7 PËRFSHIRJA NË SHOQËRI	PËRGJEGJËSIA - KULTURA E PAJTUESHMËRISË	- Respektimi i të Drejtave të Njeriut. - Mbrojtja e mjedisit dhe luftimi i ndryshimeve klimatike. - Veprimi me përgjegjësi në përfaqësimin publik. - Kontributi për një shoqëri më gjithëpërfshirëse.



INTERESAT E KLIENTIT

BNP Paribas është i përkushtuar të mbrojë interesat e klientëve për të ndërtuar besimin e tyre. Të gjithë punonjësit duhet të veprojnë gjithmonë në një mënyrë që i mbron interesat e klientëve duke respektuar të gjitha ligjet përkatëse.

Mbrojtja e interesave të klientëve është një vlerë thelbësore në BNP Paribas dhe përgjegjësi e të gjithë stafit në të gjitha aktivitetet e biznesit – nga dizajni dhe marketingu i produktit e deri te shërbimet pas shitjes dhe trajtimi i ankesave. Të kemi në mendje nevojat dhe situatën e klientëve është thelbësore për arritjen e rezultateve pozitive të klientit dhe nxitjen e besimit dhe besnikërisë.



KUPTIMI I NEVOJAVE TË KLIENTËVE DHE I SITUATËS

Ne kemi për detyrë të kuptojmë nevojat dhe situatën e klientëve dhe kemi përgjegjësi që:

- ◆ të dizajnojmë produkte duke pasur në mendje interesat e klientëve,
- ◆ gjithmonë të përpiqemi të kuptojmë nevojat, pritshmëritë dhe interesat e klientëve për t'u ofruar atyre produkte dhe shërbime adekuate, duke ofruar vlerë të drejtë,
- ◆ t'i kushtojmë vëmendje të veçantë klientëve që shihen si më të cënueshëm,
- ◆ të mos veprojmë kurrë në emër të një klienti pa autorizim (p.sh. një urdhëresë, një udhëzim klienti).



Një klient dëshiron të blejë një produkt për të cilin mendon se i nevojitet, por produkti nuk konsiderohet i përshtatshëm nga korniza qeverisëse e produktit BNP Paribas. Pavarësisht shumë diskutimeve, ai nuk do të merr parasysh alternativa tjera dhe po kërcënon ta çojë biznesin e tij diku tjetër.

Çfarë duhet të bëj?

Është përgjegjësia juaj të kaloni kohë me klientin për ta ndihmuar atë të kuptojë veçoritë e produktit dhe rreziqet që lidhen me të, pasi që ne duhet t'u ofrojmë klientëve tanë të gjitha informatat relevante. Ju duhet të shpjegoni pse besoni se produkti mund ose nuk mund të kënaqë nevojat dhe situatën e klientit. Nëse besoni se produkti nuk është në interesin e klientit, atëherë nuk duhet të përfshiheni në këtë transaksion. Ju mund të propozoni një ose më shumë alternativa adekuate. Nëse është e nevojshme, mund të kërkonit ndihmë nga menaxheri juaj. Interesat afatgjata të klientëve do të mbizotërojnë mbi fitimet afatshkurtra. Bëni këtë bisedë të sigurtë me klientin dhe largohuni nga transaksioni nëse keni nevojë.



Klientët e mi kanë një projekt të pasurive të paluajtshme. Ata duan të blejnë banesën ku ata jetojnë duke aplikuar për një kredi hipotekare. Ata dëshirojnë një normë të ulët interesi veçanërisht për të shmangur një situatë të mbi-borxhit. Unë rekomandoj që ata të marrin një kredi në valutë të huaj e cila ka një normë interesi më të ulët se një kredi hipotekare në valutën e tyre vendase.

A është i përshtatshëm ky rekomandim duke pasur parasysh që unë u ofrova klientëve të mi një kredi me një normë të mirë interesi?

Një kredi në valutë të huaj nuk është një produkt i thjeshtë pa komplikime pasi mbart karakteristika të rrezikshme që klientët jo gjithmonë mund t'i kuptojnë. Prandaj, duhet t'u ofrohet vetëm klientëve:

- të cilët e kuptojnë plotësisht rrezikun e valutës ndaj të cilës janë të ekspozuar dhe,
 - të cilët kanë aftësinë për të zbutur rrezikun (në sajë të të ardhurave të mjaftueshme ose aktiveve në valutë të huaj) ose kanë burime të mjaftueshme financiare për të absorbuar plotësisht humbjen e mundshme të madhe që mund të rezultojë nga ndryshimet e kursit të këmbimit valutor.
- Para se të rekomandoni një produkt të tillë, gjithmonë duhet të vlerësoni nevojat dhe situatën e klientëve në mënyrë që t'u ofroni atyre produktet/ shërbimet e duhura.

OFRIMI I INFORMATAVE TË DREJTA, TË QARTA DHE JO MASHTRUESE PËR KLIENTIN

Ne kemi për detyrë t'u ofrojmë klientëve informata të drejta, të qarta dhe jo mashtruese, në mënyrë që ata të marrin vendime të informuara:

◆ siguroni të gjitha informatat e kërkuar para, gjatë dhe pas procesit të shitjes për t'i mundësuar klientët të kuptojnë:

- çfarë po blejnë, duke përfshirë rezultatin e pritur, çmimet dhe karakteristikat e rrezikut,
- për çfarë po paguajnë, duke përfshirë kostot e produkteve, shërbimeve dhe këshillave të zgjedhura,

◆ të sigurojë që materialet të jenë të qasshme dhe të përmbajnë informata të duhura për t'u mundësuar klientëve t'i lexojnë dhe t'i kuptojnë ato në mënyrë efektive,

◆ ruajnë konsistencën dhe afatet kohore në informatat e dhëna në të gjitha kanalet,

◆ përgjigjuni pyetjeve të klientit sipas aftësive tona më të mira profesionale dhe në kohën e duhur.



Klienti im sapo ka trashëguar një shumë të konsiderueshme parash dhe dëshiron t'i riinvestojë ato në një produkt investimi financiar. Gama e produkteve tona të investimeve financiare është e gjerë me nivele të ndryshme rreziqesh dhe kthimesh. Duke qenë se klientit tim i pëlqejnë produktet financiare inovative, mendoj se një propozim biznesi i bazuar në një produkt me kthim shumë të lartë do të ishte opsioni i duhur si për klientin tim, ashtu edhe për profitabilitetin e Bankës.

Çfarë duhet të bëj?

Pasi të vlerësoni se rekomandimi juaj është i përshtatshëm me nevojat dhe situatën e klientit dhe oreksin/profilin e rrezikut, është detyra juaj t'i paraqisni klientit tuaj në mënyrë të balancuar tiparet, përfitimet dhe rreziqet që lidhen me produktin/shërbimin (rrezikun e tregut, rrezikun e kredisë, rreziku i kursit të këmbimit, etj.). Me fjalë të tjera, ju jeni përgjegjës për t'u siguruar që klienti është në gjendje të kuptojë natyrën e produktit dhe rreziqet e lidhura me të, ashtu që të marrë një vendim të informuar.

Një produkt që ofron një kthim shumë të lartë, gjithsesi do të mbartë një rrezik shumë të lartë dhe klienti duhet të kuptojë plotësisht natyrën dhe madhësinë e këtij rreziku, duke përfshirë një mundësi të humbjes së kapitalit.

SIGURIMI I TRAJTIMIT TË DREJTË TË KLIENTËVE

Ne kemi për detyrë që vazhdimisht të identifikojmë, parandalojmë dhe menaxhojmë çdo konflikt të mundshëm interesi që mund të dëmtojë interesat e klientëve dhe të zbusë këto rreziqe në mënyrë sa më efektive:

- ◆ sigurohuni që klientët të trajtohen gjithmonë në mënyrë të drejtë,
- ◆ aplikoni çmime të drejta dhe transparente në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi,
- ◆ mbështetni klientët që përjetojnë vështirësi financiare me durim dhe kujdes,
- ◆ në marrëdhëniet me palët e treta, prodhuesit ose furnitorët, ka një përgjegjësi për të:
 - kërkuar partnerë që respektojnë Parimet tona të Kodit të Sjelljes,
 - kuptoni rolet dhe përgjegjësitë e zhvilluesit dhe shpërndarësit e produktit.

TRAJTIMI I ANKESAVE TË KLIENTËVE NË MËNYRË TË DUHUR DHE TË DREJTË

- Ne kemi detyrë të trajtojmë ankesat e klientëve në mënyrë të duhur dhe të drejtë:
- ◆ të sigurojë qasje të qartë dhe të lirë për paraqitjen e ankesës,
 - ◆ të trajtojë ankesat e klientëve në mënyrë të drejtë, transparente dhe me kohë,
 - ◆ të rregulloj gjërat sa më shpejt që të jetë e mundur, nëse identifikohen gabime.



Një klient i pakënaqur ka bërë një ankesë një muaj më parë. Ai thërret në telefon për të më thënë se nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Banka. Ai është shumë i zhgënjyer dhe synon të transferojë kursimet e tij në një bankë tjetër.

Çfarë duhet të bëj?

Ju keni detyrë të trajtoni ankesat e klientëve në mënyrë efektive dhe të shpejtë për të rritur besimin dhe besnikërinë e klientëve.

SIGURIA FINANCIARE

Grupi BNP Paribas është i përkushtuar për t'u shërbyer klientëve të tij. Në të njëjtën kohë, Grupi duhet të jetë gjithmonë i vetëdijshëm për ndikimin që veprimet e tij mund të kenë në shoqërinë e gjerë. Grupi BNP Paribas është i përkushtuar të respektojë të gjitha ligjet e zbatueshme për parandalimin e krimit financiar, përfshirë aktivitetet e financimit të terrorizmit, dhe të mbështesë veprimet ndërkombëtare që kryhen përmes industrisë financiare.

Për shkak se këto ligje mund të jenë të ndërlikuara dhe të zbatohen ndryshe nëpër biznese dhe rajone, Grupi është i përkushtuar në promovimin e rregullave të qarta për të nxitur një kulturë të fortë pajtueshmërisë dhe etikës.

LUFTA KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE, RYSHFETIT, KORRUPSIONIT DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Është përgjegjësi e çdo punonjësi të mbështesë Grupin në luftimin e krimit financiar duke përfshirë mashtrimin, pastrimin e parave, korrupsionin dhe financimin e terrorizmit. Një Shtojcë mbi "Parandalimin, zbulimin dhe luftimin e korrupsionit dhe tregtisë me ndikim" është e përfshirë në Kodin ekzistues të Sjelljes (referojuni seksionit D). Prandaj, nga të gjithë kërkohet që:

- ◆ të jenë vigjilentë dhe të kontribuojë në luftën kundër të gjitha formave të krimit financiar duke përfshirë mashtrimin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, pavarësisht nga rrethanat ose akterët e përfshirë,
- ◆ sigurohuni që të zbatohet kujdesi i shtuar dhe kontroll adekuat për të njohur klientët dhe mënyrën se si ata përdorin produktet dhe shërbimet e Grupit,
- ◆ të jenë vigjilentë për të siguruar që transaksionet e klientëve të mos lidhen me ryshfet ose korrupsion,
- ◆ përshkallëzoni çdo operacion të dyshimtë te Menaxhmenti i Lartë ose te zyra Lokale e Pajtueshmërisë.



Sot në mëngjes, një nga klientët e mi më kërkoi të lëshoja një letër garancie për eksportin e municioneve në një vend nën sanksion (ndalimin për armë).

Çfarë veprimi duhet të ndërmarr?

Ju duhet të refuzoni transaksionin dhe të njoftoni departamentin tuaj lokal të Pajtueshmërisë.



Kam vënë re se një nëpunës civil i afërt me një ministër në detyrë në një vend ku Grupi është aktiv sapo ka marrë një shumë të madhe parash në llogarinë e tij. Ai më dha një shpjegim për këtë transferim të madh, por transaksioni ende më duket i dyshimtë.

Çfarë duhet të bëj?

Ju duhet ta referoni këtë transaksion në departamentin tuaj lokal të Pajtueshmërisë për t'u siguruar që provat e ofruara janë mjaft bindëse.

Nëse nuk janë, ekipi përkatës i Sigurisë Financiare do të vendosë dhe do të vazhdojë me dërgimin e një Raporti të Aktivitetit të Dyshimtë dhe ta dërgoj te Autoriteti përkatës.

PAJTUESHMËRIA ME SANKSIONET DHE EMBARGOT

Grupi është i përkushtuar të respektojë rregullat e zbatueshme të sanksioneve dhe embargove, që nënkupton një detyrim që të:

- ◆ kuptoni rregullat e sanksioneve dhe embargove të zbatueshme në tregjet ku Grupi funksionon, ose është në kontakt me të,
- ◆ respektoni politikën e Grupit dhe ligjet lokale (dhe çdo rregullore të zbatueshme) në lidhje me sanksionet dhe embargot në vendin në të cilin Grupi funksionon,
- ◆ raportoni te Sigurimi Financiar i Grupit çdo përpjekje për të anashkaluar regjimin e sanksioneve.



Një nga klientët e mi nisi një transferim në dollar amerikan (USD) tek një përfitues me banim në një vend nën embargo, i cili u refuzua.

Pas disa ditëve, ai tentoi të bënte të njëjtën transferim të së njëjtës shumë tek i njëjti përfitues, këtë herë me një adresë tjetër në një vend që nuk i nënshtrohet sanksioneve financiare.

A pritet që unë të bëj diçka lidhur me këtë?

Po, patjetër. Një raport i anashkalimit duhet t'i dërgohet menjëherë Sigurimit Financiar të Grupit dhe duhet të kryhet një shikim prapa në llogari për të siguruar që asnjë transaksion i ngjashëm nuk ka ndodhur në të kaluarën.

3

INTEGRITETI I TREGUT

Tregjet e drejta dhe efektive janë thelbësore për një ekonomi efikase dhe në rritje. Grupi BNP Paribas është i përkushtuar për të ruajtur dhe mbrojtur integritetin e tregjeve.

PAJTUESHMËRIA ME RREGULLAT E ABUZIMIT TË TREGUT DHE PRAKTIKAT E KONKURENCËS SË NDERSHME NË KONTEKSTIN E AKTIVITETEVE TË TREGUT

Është përgjegjësi e çdo punonjësi që të:

- ◆ respektojë rregullat për menaxhimin e informatës konfidenciale në lidhje me klientët dhe aktivitetet e tregut: (i) kurrë të mos i ndani apo keqpërdorni informatat e privilegjuara ("tregtimi i brendshëm"); (ii) kurrë mos shkëmbeni informata të ndjeshme komerciale me konkurrentë,
- ◆ shmangni sjelljen që ka gjasë të dëmtojë funksionimin pa pengesë të tregjeve; respektoni rregullat dhe standardet e tregut që synojnë të mbështesin stabilitetin, likuiditetin dhe transparencën në tregje,

- ◆ mos veproni kurrë me qëllimin për të manipuluar vlerën e një instrumenti ose indeksi financiar, qoftë në izolim apo në koordinim me palët e tjera, duke përfshirë dhënien e informatave mashtruese ose manipuluese,
- ◆ raportoni në mënyrë proaktive çdo sjellje që mund të përbëjë tentativë abuzimi në treg, duke përfshirë edhe kur përpjekja dështon. Kjo vigjilencë ka të bëjë me sjelljen e punonjësve po ashtu edhe të palëve/klientëve,
- ◆ përdorni pajisjet e komunikimit të dhëna nga Banka dhe kanalet e autorizuara të komunikimit sipas rolit tuaj dhe në përputhje me politikat dhe përjashtimet në fuqi.



Unë jam duke shkëmbyer mesazhe në lidhje me një transaksion me një nga homologët e mi përmes bisedës (chat) Bloomberg. Homologia ime më informon se ajo duhet të dalë për një drekë biznesi, por mbetet e disponueshme përmes WhatsApp.

Çfarë të bëj?

WhatsApp, përveç rasteve të kufizuara, aktualisht nuk është një kanal i autorizuar, kështu që nëse nuk keni miratim zyrtar për të përdorur WhatsApp për qëllime biznesi, duhet të informoni homologun tuaj se politikat tuaja të brendshme nuk ju lejojnë të përdorni këtë kanal komunikimi dhe t'i kërkonit asaj të përdorë një kanal të autorizuar nga Grupi. Ju kujtojmë se duhet të përdorni një pajisje të lëshuar nga BNP Paribas kur përgjigjeni në raste të tilla.



Te aparati i kafesë, rastësisht dëgjova disa informata jo zyrtare, të cilat mund të ndikojnë negativisht në vlerën e një sigurie (kolaterali) që mban një nga miqtë e mi.

Unë personalisht nuk kam asnjë interes personal dhe as nuk jam i përfshirë në ndonjë transaksion rreth asaj sigurie si pjesë e punës sime. Unë nuk dua që shoku im të humbasë para.

A mund ta ndaj informatën me të?

Jo, ju nuk duhet t'i kaloni mikut tuaj asnjë informatë materiale jo zyrtare në lidhje me një siguri, pavarësisht se si e keni marrë atë. Paralajmërimi i një individi tjetër është tregti e brendshme dhe mund të përbëjë shkelje të ligjit.



PARANDALIMI DHE SHMANGIA E KONFLIKTEVE TË INTERESAVE TRANSAKSIONALE

Grupi BNP Paribas është një institucion bankar global që u shërben klientëve në shumë vende përmes disa linjave të biznesit. Për të menaxhuar çdo konflikt interesi që mund të lindë e që përfshin Grupin BNP Paribas, është thelbësore që të:

- ◆ jeni proaktiv në lidhje me identifikimin, menaxhimin dhe zbulimin e çdo situatë ku Grupi BNP Paribas mund të ketë një konflikt interesi,
- ◆ asnjëherë mos pranoni një urdhëresë ose përkushtoheni ndaj një transaksioni në emër të Grupit BNP Paribas pa kontrolluar më parë që Grupi nuk është në konflikt.



Një klient po pyet nëse do të ishim të interesuar të merrnim pjesë në financimin e një blerjeje të një kompanie të synuar. E di që një bankier i BKI (CIB) ka një klient në të njëjtin sektor dhe dyshoj se ai mund të jetë këshilltar i atij klienti për të njëjtin transaksion.

A mund t'i konfirmoj klientit tim interesin tim për të marrë pjesë në financim?

Para se të pranoni këtë urdhëresë, duhet të siguroheni që të mos ketë konflikt në mes të këtij roli dhe roleve të tjera që mund të ketë marrë përsipër BNP Paribas. Në rast të një konflikti të identifikuar, ju duhet ta referoni këtë çështje në Komisionin e Grupit për Konfliktin e Interesit.

4

ETIKA PROFESIONALE

Integriteti dhe etika e çdo punonjësi si individ janë gurthemeli i Kodit të Sjelljes së Grupit BNP Paribas. Rregullat në këtë seksion synojnë të sigurojnë ruajtjen e standardit më të lartë të integritetit individual dhe të etikës profesionale.

ASNJËHERË MOS PËRDORNI INFORMATAT E BRENDSHME OSE INFORMATAT E TJERA KONFIDENCIALE NË TRANSAKSIONET PERSONALE

Të gjithë punonjësit duhet të respektojnë rregullat në vijim:

- ◆ jashtë rrjedhës normale të aktiviteteve profesionale, zbulimi i çdo informate konfidenciale është rreptësisht i ndaluar (përfshirë kur këshillon ose ndihmon ndonjë palë të tretë),
- ◆ në lidhje me transaksionet personale mbi instrumentet financiare, të gjithë punonjësit nuk duhet të përdorin kurrë informatat konfidenciale, as të kryejnë

ndonjë transaksion gjatë posedimit të informatës së brendshme (tregtimi i brendshëm),

- ◆ të gjithë punonjësit e klasifikuar si të ndjeshëm duhet gjithashtu të angazhohen për të respektuar rreptësisht politikatat e brendshme në lidhje me Trajtimin e Llogarive Personale, veçanërisht për të mos kryer kurrë transaksione personale që lidhen me përgjegjësitë e tyre profesionale dhe për të deklaruar të gjitha llogaritë e instrumenteve financiare dhe transaksionet personale në fushëveprim.

PARANDALIMI DHE SHMANGIA E KONFLIKTEVE TË INTERESIT NË URDHËRESA DHE INTERESA TË JASHTME TË BIZNESIT

BNP Paribas mbështet punonjës të marrin pjesë në aktivitete sociale dhe i inkurajon ata të luajnë një rol në komunitetin e tyre. Megjithatë, këto mandate dhe aktivitete të interesit të jashtëm të biznesit mund të shkaktojnë konflikte në mes të interesave të biznesit dhe interesave private.

Rrjedhimisht, çdo punonjës duhet të ketë parasysh të:

- ◆ jetë në përputhje me politikat e brendshme të Grupit në lidhje me aktivitetet e jashtme,
- ◆ gjithmonë kërkon miratim paraprak për çdo mandat të korporatës jashtë Grupit BNP Paribas dhe, për anëtarësime të reja, zbuloni gjithmonë mandatet ekzistuese të korporatës,
- ◆ zbuloni gjithmonë çdo aktivitet biznesi jashtë Grupit BNP Paribas⁴ ku mund të lindin konflikte interesash,
- ◆ asnjëherë mos e përfshini Grupin në lidhje me aktivitetet personale pa aprovim paraprak formal.

4 – Përjashtimisht aktiviteteve të sindikatave si të përcaktuara në 'Code du travail' francez.



Unë jam një menaxher për marrëdhënie në BNP Paribas dhe në baza private, unë menaxhoj kompani. Unë jam duke menduar zhvillimin e biznesit të kompanive personale me klientët e BNP Paribas pasi që ata investojnë në aktivitete të ngjashme.

A jam në rrezik?

Po. Së pari, duhet të kishit identifikuar dhe vlerësuar çdo konflikt të mundshëm ose të perceptuar interesi dhe t'i kishit deklaruar këto kompani personale menaxherit tuaj dhe zyrës së pajtueshmërisë. Së dyti, nuk duhet të përzieni aktivitetet tuaja profesionale në BNP Paribas me aktivitetet tuaja personale, duke përfshirë mospërdorimin e kohës dhe burimeve tuaja në Bankë dhe ridrejtimin e biznesit të Bankës për të mirën e kompanive tuaja personale.



Unë jam duke menaxhuar transaksione me të ardhura fikse me korporatat në BNP Paribas. Partneri im punon për një palë e cila ka një marrëdhënie biznesi me BNP Paribas dhe mund të veprojë në emër të kësaj pale për të lidhur ose negociuar me BNP Paribas për çmimet dhe kuotimin e transaksioneve me të ardhura fikse.

A jam në rrezik?

Potencialisht, po. Së pari, ju duhet të vlerësoni dhe deklaroni këtë marrëdhënie personale të menaxherit tuaj dhe me zyrën e Pajtueshmërisë, pasi potencialisht kjo po krijon një konflikt interesi. Së dyti, duhet të siguroheni që nuk jeni të përfshirë në transaksione me këtë palë dhe të respektoni masat zbutëse që janë vendosur.



Më është ofruar një pozitë në bordin e një kompanie dhe e kam pranuar propozimin pasi aktivitetet e saj nuk konkurrojnë me aktivitetet e BNP Paribas.

A jam në rrezik?

Potencialisht, po, pasi mund të mos keni informata të plota në lidhje me këtë kompani, si mund të ndërveprojë me BNP Paribas dhe nëse mund të krijojë një konflikt interesi të mundshëm ose të perceptuar. Ju duhet të vlerësoni dhe deklaroni këtë pozitë te menaxherin tuaj dhe me zyrën e Pajtueshmërisë dhe të merrni miratimin paraprak të tyre pasi potencialisht kjo mund të krijojë një konflikt interesi.”



Për organizimin e seminarit vjetor të ardhshëm jam tunduar të propozoj një hotel buzë detit që i përket kumatit tim. Jam i sigurt se sharmi i vendit do të jetë një hit i vërtetë, veçanërisht duke ditur se hoteli është më pak i shtrenjtë se hotelet konkurruese. Për më tepër, do të ndihmojë edhe familjen!

A është ajo e lejuar?

Cilado qoftë cilësia e shërbimeve të ofruara nga marrëdhëniet tuaja personale, duhet të inicohet procesi i përzgjedhjes së furnizuesit. Nëse hoteli i kumatit është pjesë e përzgjedhjes, mos merrni pjesë në vendim, kjo për të shmangur një konflikt interesi.”



Dëshiroj ta ftojë një klient në një ngjarje sportive ndërkombëtare të sponsorizuar nga BNP Paribas, por klienti ndodhet jashtë vendit dhe kostot e mikpritjes mund të jenë të larta.

A është e mundur kjo?

Një numër i madh klientësh janë të ftuar në këtë lloj eventesh për të promovuar markën dhe imazhin e kompanisë. Ftesat janë të mundshme brenda kufijve të parashikuar sipas procedurave. Ju duhet të merrni miratimin paraprak të menaxherit tuaj të linjës dhe zyrës së Pajtueshmërisë në lidhje me kostot e transportit dhe mikpritjes.”

ASNJËHERË TË MOS SHKËMBEHEN INFORMATAT E NDJESHME KOMERCIALE ME KONKURRENTËT DHE ASNJËHERË MOS U KOORDINONI ME KONKURRENTËT MBI POLITIKËN TREGTARE TË GRUPIT

Këto rregulla zbatohen pavarësisht nga konteksti (shoqata profesionale, shkëmbimet në një kapacitet formal – të tilla si partneritetet apo konteksti joformal – siç janë ngjarjet sociale, etj.) dhe mënyrave (me gojë, me shkrim).



Unë jam duke punuar në një tender dhe jam në dijeni që një koleg i një banke konkurrencte po përgatit një ofertë. Ne po e mendojmë opsionin të përgjigjemi së bashku ashtu që secili prej nesh të fitojë një pjesë të ofertës. A jam në rrezik?

Potencialisht, po, pasi është një analizë nga rasti në rast. Duhet t'i referoheni menjëherë zyrës së Pajtueshmërisë/LEGAL para çdo veprimi.

5

RESPEKT PËR PERSONAT

Grupi BNP Paribas aspiron të nxisë një vend pune stimulues ku njerëzit trajtohen në mënyrë të drejtë dhe pret që të gjithë punonjësit të shfaqin sjellje profesionale në çdo rrethanë.

ZBATIMI I STANDARDEVE MË TË MIRA TË SJELLJES PROFESIONALE

Çdonjëri ka përgjegjësi që të sillet profesionalisht dhe përgjegjshëm ndaj njerëzve, që do të thotë se ne jemi të përkushtuar që të:

- ◆ jemi proaktivë në njohjen dhe respektimin e politikave, procedurave dhe udhëzimeve të tjera të përhershme të Grupit të dhëna nga menaxhmenti në lidhje me aktivitetet tona profesionale,
- ◆ respektojmë rregullat e zbatueshme të sekretit profesional në çdo kohë,
- ◆ trajtojmë të gjithë njerëzit me respekt,
- ◆ sigurojmë që ndërveprimet me njerëzit të jenë profesionale dhe efektive në çdo kohë,
- ◆ dëgjojmë dhe vlerësojmë kontributet nga njerëzit, edhe nëse ata shprehin pikëpamje që mund të dallojnë nga tuajat.



Si menaxher dhe lider, si mund të promovoj sjellje të mirë në organizatë?

Ju duhet të jeni shembull për tjerët dhe të mbani veten sipas standardeve më të larta etike. Krijoni një mjedis komunikimi të hapur dhe të ndershëm, si dhe inkurajoni diskutimin e etikës dhe integritetit në vendimet e biznesit në takimet e ekipit.

Bëjini të ditur punonjësve se ata mund dhe duhet të raportojnë çdo shqetësim për sjelljeje që kanë, pa pasur nevojë të shqetësohen për ndonjë hakmarrje eventuale.



Unë jam një menaxher dhe kam dëgjuar diskutime që sugjerojnë sjellje joadekuate në një fushë tjetër të biznesit. Nuk bie nën përgjegjësinë time, kështu që, a duhet që ende të ngre shqetësimet e mia?

Të gjithë personat, madje edhe përtej menaxherëve, janë përgjegjës për ngritjen e çdo shqetësimi në lidhje me sjelljen që mund të jetë në kundërshtim me ligjet, rregulloret, Kodin e Sjelljes, politikat ose procedurat e Grupit. Ngritja e një shqetësimi është një e drejtë dhe asnjë punonjës nuk mund të sanksionohet, largohet nga puna ose diskriminohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për ngritjen e një shqetësimi në mirëbesim. Për të ngritur një shqetësim (sinjal), ju tani keni një platformë të vetme dhe të sigurt për mbledhjen e sinjalizimeve, pavarësisht nëse kanë të bëjnë me Respektin për personat apo çdo lloj situatë tjetër. Kjo platformë, e quajtur Platforma e BNP Paribas për Sinjalizim “BNP Paribas Whistleblowing Platform”, është e qasshme [përmes këtij linku](#). Para se të hyni në të, mund të dëshironi të diskutoni situatën me dikë sipas zgjedhjes suaj. Ky person mund të jetë menaxheri juaj ose ndonjë menaxher tjetër:

- PBBNJ-ja juaj dhe/ose një anëtar lokal i BNJ,
- një korrespondent i Diversitetit, Barazisë dhe Inkluzionit, ose – nëse ekzistojnë në nivelin lokal – një aktor mjekësor ose social, ose një përfaqësues i stafit.

REFUZIMI I ÇDO FORME TË DISKRIMINIMIT

Grupi BNP Paribas është i përkushtuar për të ruajtur një mjedis pune pozitiv ku të gjithë njerëzit trajtohen me respekt dhe dinjitet. Për të respektuar të tjerët, punonjësit nuk duhet të diskriminojnë asnjë person brenda Grupit. Punonjësit duhet të:

- ◆ promovojnë trajtimin e drejtë të kandidatëve në procesin e rekrutimit, bazojnë gjithmonë gjykimin mbi kompetencat dhe aftësitë e vlerësuar objektivisht, garantojnë mundësi të barabarta dhe përcaktojnë kushtet e shpërbërimit në mënyrë të drejtë dhe të barabartë,
- ◆ refuzoni të gjitha format e diskriminimit, bullizimit ose ngacmimit ndaj punonjësve të tjerë, klientëve ose çdo personi me një lidhje me Grupin BNP Paribas bazuar në faktorë të ndaluar si gjinia, kombësia, shëndeti, paaftësia, mosha, identiteti (përfshirë origjinën),
- ◆ të mos përfshihen në ngacmime seksuale ose të sillen në një mënyrë që mund të interpretohet si e tillë. “Ngacmim seksual” përkufizohet si çdo sjellje e natyrës seksuale që cenon dinjitetin e njerëzve, e cila mund të konsiderohet si e padëshiruar, e papranueshme, e papërshtatshme dhe fyese për marrësin dhe që krijon një mjedis pune intim, armiqësor, të paqëndrueshëm ose fyës.



Kam dëgjuar tërthorazi një person duke iu referuar dikujt tjetër duke përdorur gjuhë raciste.

Çfarë duhet të bëj?

Ju mund t'i thoni diçka direkt këtij personi nëse ndiheni përshtatshëm ta bëni këtë, por në çdo rast duhet të kontaktoni menaxherin tuaj dhe/ose departamentin e Burimeve Njerëzore ose të përdorni kanalin e sinjalizimit për të ngritur shqetësimet tuaja. Mund të jetë më e lehtë të shikosh nga ana tjetër, por ne të gjithë kemi përgjegjësi për të krijuar dhe mbajtur një mjedis pune të respektueshëm dhe bashkëpunues.



GARANTIMI I SIGURISË NË VENDIN E PUNËS

Grupi konsideron sigurinë në vendin e punës si një fuqi kyçe dhe është përgjegjësi e çdo punonjësi të:

- ◆ merr pjesë në promovimin e një vendi pune të sigurt dhe pa pengesa për aktivitetet e përditshme dhe në përputhje me politikën e brendshme të Grupit,
- ◆ kërkojë të ndërmarrë veprime për të përmirësuar kushtet e punës së ekipeve, kur vepron si menaxher,
- ◆ raportoni çdo aktivitet që mund të nënkuptojë një kërcënim për sigurinë fizike të një punonjësi ose një personi të jashtëm që bën biznes në ambientet e Grupit BNP Paribas.



Kam qenë dëshmitar i një personi që i bën komente të papërshtatshme sugjeruese seksuale një personi tjetër.

Çfarë duhet të bëj?

Secili ka një rol për të luajtur në krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi pune në të cilin respektohet dinjiteti i tyre, në të cilin viktimat e diskriminimit dhe ngacmimit nuk do të ndiejnë se ankesat e tyre shpërfillen ose banalizohen, ose të kenë frikë nga hakmarrja. Ju mund të flisni me personat e përfshirë nëse ndiheni përshtatshëm ta bëni këtë; ju duhet ta raportoni këtë situatë përmes platformës së sinjalizimit të BNP Paribas. Para se të hyni në të, mund të dëshironi të diskutoni shqetësimet tuaja me dikë sipas zgjedhjes suaj, ndoshta menaxherin ose Partnerin tuaj të Burimeve Njerëzore.

MBROJTJA E GRUPIT

Të gjithë punonjësit kanë obligim të mbrojnë dhe mbështesin qëndrueshmërinë afatgjatë të biznesit të Grupit BNP Paribas. Grupi pritët të ruajë menaxhimin e tij të orientuar në aspektin afatgjatë, ashtu që të përforcojë vazhdimisht stabilitetin e tij, në interes të vetë Grupit, të aksionarëve të tij dhe të ekonomisë në përgjithësi.

NDËRTIMI DHE MBROJTJA E VLERËS AFATGJATË TË GRUPIT BNP PARIBAS

Për të ndërtuar dhe ruajtur vlerat afatgjatë të Grupit BNP Paribas, është thelbësore që të:

- ◆ merrni pjesë në ruajtjen dhe mbrojtjen e të gjitha pasurive fizike dhe jo-materiale të Grupit, pasurive teknologjike, intelektuale dhe financiare, Emrin e kompanisë, markës dhe marrëdhënieve me klientët,
- ◆ parandalojë keqpërdorimin e këtyre pasurive dhe burimeve për përfitimin e cilido personi tjetër, qoftë vullnetarisht apo nga neglizhenca, veçanërisht në një mënyrë që mund të paragjykojë interesat e Grupit BNP Paribas,
- ◆ vendos gjithmonë suksesin afatgjatë, në përputhje me udhëzimet strategjike të Grupit BNP Paribas, përpara përfitimit afatshkurtër për të mbrojtur markën dhe reputacionin e Grupit BNP Paribas.

MBROJTJA E INFORMATAVE TË GRUPIT

Është jashtëzakonisht e rëndësishme të mbroni informatat e Grupit në të gjitha rrethanat. Grupi BNP Paribas i janë besuar vazhdimisht një sasi e madhe të dhënash të ndjeshme, të cilat janë një nga pasuritë e tij strategjike, kritike për aktivitetet e tij. Përdorimi i teknologjive të reja

për menaxhimin e të dhënave (p.sh. Cloud, big data, inteligjenca artificiale, blockchain) dhe aplikacioneve digjitale (media sociale, email, hapësira të përbashkëta, etj.) krijon burime të reja rreziqesh, të tilla si rreziqet e sigurisë kibernetike. Grupi duhet të jetë i përgatitur për të përballuar kërcënimin e këtyre rreziqeve dhe përpjekjeve për të dëmtuar integritetin e të dhënave të tij. Në këtë kontekst, Grupi mbështetet tek çdo punonjës që të:

- ◆ respektojë dhe zbatojë standardet më të larta të sigurisë kibernetike, udhëzimet, kërkesat dhe praktikrat më të mira në përputhje me Rregullat e Arta të Sigurisë Kibernetike dhe kornizën e sigurisë kibernetike të Grupit,
- ◆ zbatojë rregullat e miratuara të trajtimit në çdo fazë të ciklit jetësor të informatave për të siguruar që informatat e Grupit janë klasifikuar me kujdes dhe në mënyrë të duhur (d.m.th., privat, publik, i brendshëm, konfidencial, sekret) të përdoren, ruhen, qasen, zbulohen, transferohen dhe fshihen, gjithmonë,
- ◆ gjatë misionit tuaj në BNP Paribas ose pas daljes nga Grupi, mos transferoni kurrë pa autorizim paraprak asnjë informatë (p.sh. të dhëna, fajla, dokumente) të BNP Paribas jashtë Grupit, qoftë në korrierë personale dhe/ose hapësira të jashtme fizike ose logjike të ruajtjes (p.sh. hapësirat e ruajtjes virtuale) ose përmes printimit në letër.



Është fundi i ditës dhe prezantimi im për takimin e bordit drejtues të planifikuar nesër është pothuajse i përfunduar. Për të përfunduar punën nga shtëpia, po mendoj të dërgoj dokumentet përgatitore dhe draft prezantimin (të klasifikuar si konfidencial), në emailin tim personal, duke e lënë laptopin e punës në zyrë.

A është kjo praktikë e mirë?

Është kundër politikave të BNP Paribas transferimi i dokumenteve që i përkasin Grupit në një email ose pajisje personale. Respektimi i politikave të sigurisë së të dhënave është thelbësor për të parandaluar thyerjet e të dhënave. Veglat për Parandalimit e Rrjedhjeve të të Dhënave (DLP) janë të vendosura në të gjithë Grupin për të zbuluar dhe penguar çdo transferim të paautorizuar të informatave të Bankës. Detyrat që lidhen me punën, duhet të kryhen duke përdorur pajisje të ofruara nga kompania për të garantuar sigurinë e të dhënave. Mosrespektimi i rregullave të Grupit për trajtimin e të dhënave mund të çojë në pasoja disiplinore dhe ligjore.



RUAJTJA E PRIVATËSISË INDIVIDUALE

Ne përpunojmë vëllime të mëdha të dhënash në aktivitetet tona të përditshme dhe mes tyre, të dhëna personale të klientëve tanë individualë, punonjësve dhe partnerëve. Ruajtja e privatësisë së tyre, mbrojtja e të dhënave të tyre dhe ruajtja e besimit të tyre mbetet e një rëndësie të madhe për BNP Paribas, në kontekstin e teknologjive të reja me rritje të shpejtë që sjellin kapacitete shtesë për shërbimin ndaj klientit dhe krijimin e vlerës për Grupin.

Punonjësit e Grupit janë të përkushtuar që të:

- ◆ respektojnë rregullat e Grupit për mbrojtjen e të dhënave personale
- ◆ sigurojnë që individët janë të informuar për përpunimin e të dhënave personale,
- ◆ mbledhin dhe përpunojnë të dhënat personale vetëm për qëllime të qarta dhe legjitime,
- ◆ mbajnë të dhënat personale vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për të përm-bushur qëllimin e synuar të përpunimit dhe jo më gjatë se sa kërkohet në përputhje me detyrimet ligjore.



Të shqyrtojmë një skenar nga jeta reale që mund të ndodhë brenda roleve tona të rekrutimit të menaxherëve. Imagjinoni veten duke u përgatitur për të intervistuar një kandidat për një vend të lirë pune në ekipin tuaj. Si këshilltar i klientëve të bankimit me pakicë, ju keni qasje të privilegjuar në bazën e të dhënave të klientëve. Gjatë përgatitjes suaj, zbuloni se kandidati ka llogari personale dhe profesionale, është prind i dy fëmijëve dhe është i divorcuar.

A është e pranueshme të përdoret kjo informatë personale gjatë intervistës?

A është e pranueshme të shkoni dhe të kërkonit këtë informatë para intervistës?

Sipas politikave të Grupit, përdorimi i të dhënave personale nga baza e të dhënave të klientit është rreptësisht i kufizuar për qëllimet për të cilat janë mbledhur. Në këtë rast, informata është mbledhur për qëllime bankare, jo për qëllime të BNJ, dhe për këtë arsye nuk mund të përdoret në procesin e punësimit. Për më shumë, çdo informatë e përdorur për punësim duhet të jetë e lidhur drejtpërdrejt me pozitën e punës. Ky skenar thekson rëndësinë e respektimit të rregulloreve të privatësisë së të dhënave dhe garantimit që proceset tona të punësimit të kryhen me integritet dhe respekt për privatësinë e kandidatit.



Unë jam një këshilltar i klientëve të bankimit me pakicë. Një kërkesë e fundit nga një koleg për gjendjen e llogarisë së kursimeve të gjyshes së tyre më vë në një situatë delikate. Ajo është kliente e imja. Kolegu im po kërkon të blejë një shtëpi të re dhe llogarit në mbështetjen e saj financiare.

Çfarë duhet të bëj?

Ja se si mund ta kaloni këtë skenar me integritet:

- respektoni Privatësinë: Qasja në të dhënat personale është rreptësisht e kufizuar për qëllimet për të cilat janë mbledhur, p.sh. në këtë rast, për qëllime bankare,
- shmangni Përdorimin Personal: Qasja në të dhënat e klientit për arsye personale nuk lejohet. Roli juaj është të mbronit informatat e klientëve tuaj, jo t'i përdorni ato për kërkesa personale,
- raportoni Keqpërdorimin: Nëse jeni në dijeni të ndonjë keqpërdorimi të të dhënave të klientit, është detyra juaj t'ia raportoni menaxherit tuaj këtë dhe Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave (ZMDh/DPO),
- respektoni sekretin bankar: është e domosdoshme të ruani konfidencialitetin e informatave të klientëve tuaj.

Duke iu përmbajtur këtyre udhëzimeve, ju ruani besimin e dhënë tek ju nga klientët tuaj dhe Grupi, duke siguruar që sjellja juaj profesionale të mbetet e paprekur.

KOMUNIKIMI ME PËRGJEGJËSI

Ekziston një detyrë e fuqishme për të komunikuar me përgjegjësi në çdo kohë, që do të thotë:

- ◆ kurrë mos vë në rrezik reputacionin e Bankës kur flet jashtë për ndonjë temë që lidhet me Grupin BNP Paribas,
- ◆ kurrë mos shkëmbe informata të ndjeshme komerciale me konkurrentët, përveç kërkesave legjitime (rregullatorët, menaxhmenti, etj.),
- ◆ respektimi i politikës së brendshme të Grupit në lidhje me përdorimin (publikimin, ndarjen ose ndërveprimin) e mjeteve digjitale dhe mediave sociale të brendshme dhe të jashtme.



Unë punoj për një subjekt të Grupit BNP Paribas që ushtron një aktivitet jobankar. Më duhet të marr pjesë në një takim ku përfshihen disa nga konkurrentët e mi.

A zbatohen rregullat e ligjit të konkurrencës?

Po, ligji i konkurrencës zbatohet për të gjithë punonjësit e Grupit BNP Paribas, pavarësisht nga aktiviteti në fjalë, ose nëse ai është i rregulluar apo jo.



VEPRIMI NË MËNYRË ETIKE ME PALËT E JASHTME

Mbrojtja e Grupit përfshin veprimin etik me palët e jashtme, që do të thotë të:

- ◆ kërkojë marrëdhënie reciproke të dobishme me furnizuesit e Grupit për të nxitur sjelljen etike përmes zinxhirit të furnizimit dhe për të parandaluar rreziqet që lidhen me varësitë reciproke,
- ◆ respektojë politikën e brendshme të Grupit në lidhje me aktivitetet e jashtme,
- ◆ respektojë ligjet e konkurrencës për të nxitur konkurrencën e lirë dhe të ndershme në mes të këtyre akterëve të tregut, pavarësisht nga tregjet në fjalë (të rregulluara dhe të parregulluara).



Vura re në lajme se një menaxher i një prej furnizuesve tanë është përfshirë në një skandal korrupsioni.

Çfarë duhet të bëj?

Ju duhet ta ngrini menjëherë këtë çështje te menaxheri juaj, zyrën e Pajtuëshmërisë dhe ekipin e Prokurimit. Nga furnizuesit e Grupit kërkojnë të njëjta standarde etike si nga vetë Grupi. Ka gjasë që Prokurimi të jetë tashmë i vetëdijshëm për këtë çështje dhe të rishikojë furnizuesin, por është më mirë të lajmëroni e të jeni të kujdesshëm në interes të Grupit.

MARRJA E RREZIQEVE ME PËRGJEGJËSI DUKE SIGURUAR KONTROLL TË RREPTË TË RREZIKUT

Ndërgjegjësimi për rrezikun, menaxhimi dhe kontrolli i rrezikut janë thelbësorë për të mbrojtur Grupin dhe reputacionin e tij. Bordet e dedikuara sigurojnë që vendimet më të mira të merren kolektivisht (p.sh. Komisioni i Kredive, Komisioni i Veprimtarisë së Re, etj.), me procese formale të përshkallëzimit. Secili ka një rol të rëndësishëm për të vepruar me përgjegjësi në këto çështje në fushat e tyre të përgjegjësisë. Prandaj, ekziston një detyrë që të:

- ◆ veproni në përputhje me praktikën më të mirë të Grupit BNP Paribas në pajtueshmërinë, parandalimin e mashtrimit dhe menaxhimin e rrezikut dhe kontrollet e brendshme në përgjithësi. BNP Paribas ka miratuar një përkufizim të gjerë për mashtrimin, duke pritur që sjellja e punonjësve të saj të jetë pa vërejte,
- ◆ të bëjnë çdo përpjekje për të parashikuar rreziqet që mund të lindin në aktivitetet e përditshme,
- ◆ të jenë të përkushtuar për të kontrolluar rreptësisht rrezikun për të mbrojtur klientët dhe sistemin financiar në tërësi,
- ◆ të kuptojnë dhe ndjekin një proces të përpiktë dhe të bashkërenduar të bazuar në një kulturë të fortë, të rrezikut të përbashkët, e cila përshkon të gjitha nivelet e Grupit para se të marrë ndonjë vendim ose përkushtim,
- ◆ të monitorojnë dhe balancojnë në mënyrë aktive rreziqet dhe rezultatet derisa ato të materializohen.



Kolegu im po kryen transaksione përtej kufijve të përcaktuar në mandatin e tij pa udhëzim të klientit për të fshehur një veprim të gabuar ose gabim.

Çfarë duhet të bëj?

Ju duhet t'i përshkallëzoni rastin te menaxhmenti juaj, Funkcioni i RISK dhe Inspektimit të Përgjithshëm pa vonesë çdo informatë në lidhje me një mashtrim ose një tentativë mashtrimi, ose ndonjë dyshim serioz dhe domethënës për mashtrim që ju vjen në dijeni.

PËRGJEGJSHMËRIA PASI TË LARGOHENI NGA GRUPI BNP PARIBAS

Edhe kur të largohet nga Grupi BNP Paribas, çdo punonjës ka ende një përgjegjësi ndaj Grupit dhe klientëve të tij, prandaj ata duhet që:

- ◆ asnjëherë të mos transferojnë informata (p.sh. të dhëna, fajlë, dokumente) që i përkasin Grupit BNP Paribas në një vend të jashtëm kur largoheni nga Grupi,
- ◆ mos të mbani kurrë dokumente që i përkasin Grupit BNP Paribas pas largimit nga Grupi,
- ◆ respektoni politikën e brendshme të Grupit dhe detyrimin personal për të mos krijuar konkurrencë të pandershme, nëse është e aplikueshme.

PËRFSHIRJA NË SHOQËRI

Grupi BNP Paribas aspiron të jetë një kontribues në zhvillimin e përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm global. Ambicia e tij është të jetë një lider në financat e qëndrueshme dhe të ketë një ndikim pozitiv në shoqërinë në tërësi, si në operacionet e veta, zinxhirin e furnizimit, si dhe përmes produkteve dhe zgjidhjeve që bizneset e tij ofrojnë për klientët e tij. Ky seksion i rregullave të sjelljes detajon rregullat dhe kërkesat për punonjësit e Grupit BNP Paribas për të mbështetur këto aspirata.

RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

Grupi BNP Paribas është i përkushtuar të respektojë të drejtat e njeriut në realizimin e aktiviteteve të tij dhe të promovojë të drejtat e njeriut brenda sferës së tij të ndikimit, d.m.th në mesin e punonjësve, furnizuesve, klientëve, kompanive në të cilat Grupi investon dhe komuniteteve në të cilat Grupi funksionon. Grupi në asnjë mënyrë nuk dëshiron të jetë bashkëpunëtor në ndonjë shkelje të mundshme të të drejtave të njeriut përmes aktiviteteve të tij financuese dhe investuese.

Nga punonjësit e Grupit BNP Paribas pritët të respektojë të drejtat e njeriut dhe veçanërisht që:

- ◆ gjithmonë të marrin parasysh ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të aktiviteteve të tyre mbi të drejtat e njeriut,
- ◆ të sigurojë pajtueshmërinë me kriteret në lidhje me ndikimin në të drejtat e njeriut të përcaktuara nga Grupi për të kryer aktivitetet e tij (operacionet e veta, financimi dhe investimi, prokurimi).



Një nga klientët e mi, një grup për shpërndarje malli me funksionim në shumë vende, përballet me akuza për bashkëkryerje të shkeljes së të drejtave të njeriut. Një nga furnizuesit kryesorë të saj akuzohet nga OJQ-të për përdorimin e punës së detyruar në fabrikat e saj. Organizatat e shoqërisë civile dhe figurat me ndikim tashmë kanë ushtruar publikisht presion ndaj institucioneve të tjera financiare për t'i dhënë fund marrëdhënieve me këtë klient.

Çfarë duhet të bëj?

BNP Paribas ka krijuar një kornizë të fortë për menaxhimin e rreziqeve MSQ/ESG (Mjedisore, Sociale dhe Qeverisëse) që lidhen me financimin dhe aktivitetet e saj investuese. Në zbatim të kësaj të fundit, ky klient i kontraverz duhet kontaktuar sa më parë për të verifikuar bazën e akuzave ndaj tij. Nëse ky dialog bën të mundur identifikimin e shkeljeve të kërkesave të ESG të shprehura nga Grupi, duhet të hartohet një plan rehabilitues dhe zbatimi i tij të monitorohet në intervale të rregullta, nga menaxheri i marrëdhënieve, i cili, nëse është e nevojshme, mund të kontaktojë me personin e PShC/CSR nga subjekti i saj dhe të mbështetet mbi ekspertizën kolektive të rrjetit PShC/CSR të BNP Paribas.

MBROJTJA E MJEDISIT DHE LUFTIMI I NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Grupi BNP Paribas përpiqet të kufizojë çdo ndikim mjedisor që rezulton në mënyrë indirekte nga aktivitetet e tij financuese dhe investuese ose drejtpërdrejt nga operacionet e tij. Në këtë kontekst, Grupi e konsideron luftën kundër ndryshimeve klimatike një prioritet dhe është i përkushtuar të përafrojë portofolin e tij me trajektoret e pajtueshme me neutralitetin kolektiv të karbonit deri në vitin 2050 dhe të mbështesë klientët e tij në kalimin drejt një ekonomie të qëndrueshme dhe me karbon më të ulët.

Punonjësit e Grupit BNP Paribas kanë përgjegjësi që:

- ◆ gjithmonë të marrin parasysh ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta që dalin nga aktivitetet e tyre,
- ◆ të sigurojnë pajtueshmërinë me kriteret mjedisore që Grupi ka krijuar për të drejtuar aktivitetet e tij (operacionet e veta, financimi dhe investimi, prokurimi),
- ◆ të kontribuojnë në mënyrë aktive në arritjen e objektivave të vendosura nga Grupi për të reduktuar ndikimet e operacioneve të tij të përditshme në mjedis.

VEPRIMI ME PËRGJEGJËSI NË PËRFAQËSIMIN PUBLIK

Grupi BNP Paribas synon të japë një kontribut konstruktiv në procesin demokratik duke u ofruar vendimmarrësve publikë, në përputhje të rreptë me rregullat ligjore dhe etike, informata për të ndihmuar diskutimet e tyre dhe për t'i ndihmuar ata të marrin vendime të drejta dhe të informuara. Prandaj, ekziston një detyrë për të vepruar me përgjegjësi në lidhje me autoritetet publike.



Më ka kontaktuar një tregtar i mallrave bujqësore (fruta ekzotike, sojë, misër) për të financuar një nga transaksionet e saj. Çfarë duhet të bëj?

Spektori i bujqësisë mbulohet nga politika e financimit dhe investimit. Kjo politikë trajton veçanërisht nevojën për të luftuar shpyllëzimin e lidhur me prodhimin e mishit të viçit dhe sojës në rajonet e Amazonas dhe Cerrado në Brazil. Prandaj duhet të kontaktoni zyrtarin tuaj lokal të Qëndrueshmërisë për të kontrolluar se si ta vlerësoni këtë kompani kundrejt kriterëve të politikës (të drejtat e njeriut, mbrojtja e mjedisit, etj.) dhe kërkesat në lidhje me shpyllëzimin. Në këtë rast specifik, është e rëndësishme të konsideroni origjinën e sojës së tregtuar të kompanisë, veçanërisht për të ditur nëse ajo vjen nga Amazona apo Cerrado në Brazil dhe, nëse po, të kontrollohet nëse zbaton një strategji 100% gjurmueshmërie dhe zero shpyllëzim në zinxhirin e furnizimit me sojë.

KONTRIBUTI PËR NJË SHOQËRI MË GJITHËPËRFSHIRËSE

Grupi përdor të gjitha ndikimet që ka në dispozicion, si ofrues i shërbimeve financiare dhe investimeve, punëdhënës dhe avokues, për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe të harmonizuar të shoqërisë. Vepron në veçanti për të nxitur zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të rajoneve. Grupi gjithashtu përpiqet t'u kushtojë vëmendje të veçantë klientëve në situata cënueshme dhe të lehtësojë qasjen e tyre përmes zhvillimit të produkteve dhe shërbimeve financiare të përshtatura dhe të qasshme. Punonjësit e Grupit BNP Paribas duhet të sigurojnë që ata të marrin parasysh ndikimin social të aktiviteteve të tyre.

KODI I SJELLJES NË PRAKTIKË

Kodi i Sjelljes ofron qartësi për të gjithë punonjësit lidhur me atë që pritët prej tyre gjatë ushtrimit të roleve dhe përgjegjësi të tyre.

Vlerësimi vjetor i performancës do t'u mundësojë menaxherëve të ritheksojnë rëndësinë e “të jetuarit sipas vlerave” dhe të nxjerrin në pah sjelljet e duhura siç përshkruhet në Kodin e Sjelljes për anëtarët e ekipit të tyre.

Këto sjellje do të kontribuojnë gjithashtu në gjenerimin e qartësisë dhe transparencës më të madhe për punonjësit rreth “standardeve të përgjithshme etike” të pritura nga Grupi BNP Paribas dhe nga autoritetet rregullatore përkatëse.

Trajnimi (e-mësimi), i zhvilluar dhe i shpërndarë për të gjithë stafin, i ndihmon punonjësve që të përmbushin rolet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me prioritetet e përcaktuara në Kodin e Sjelljes. Të gjithë punonjësit e Grupit kanë për detyrë që:

- ◆ të njohin dhe respektojnë të gjitha rregullat e sjelljes të përfshira në Kod,
- ◆ të kryejnë të gjitha trajnimet e nevojshme dhe të identifikuar për të kuptuar përgjegjësitë e tyre,
- ◆ të punojnë dhe bëjnë biznes në përputhje me Kodin në të gjitha aspektet e rolit të tyre,
- ◆ të jenë vigjilentë dhe sfidojnë të tjerët nëse nuk veprojnë në frymën e Kodit,
- ◆ të sigurojë konfidencialitetin e informatave, duke përfshirë respektimin e rregulloreve të sekretit bankar.

Të gjithë punonjësit e Grupit duhet të përdorin kornizën e sinjalizimit të Grupit që nëse është e nevojshme të reagojnë dhe ngrisin zërin menjëherë për shqetësimet e tyre.

Grupi nuk do të tolerojë shkelje të Kodit të Sjelljes. Do të merren masat e duhura kundër punonjësve që nuk respektojnë Kodin e Sjelljes në përputhje me ligjet vendore, rregulloret lokale dhe politikën e BNJ të Grupit⁵.

5 – Përfshirë dokumentin ‘Reglement Interieur de BNP Paribas SA’ në Francë

MARRJA E VENDIMEVE

Përderisa rregullat e sjelljes, duke përfshirë politikat dhe procedurat, si dhe mbështetjen e menaxhimit, mund të ndihmojnë me udhëzime për çdo vendim, nuk ka një rregull përkatës për çdo situatë. Në fund të fundit, marrja e vendimit të duhur duhet të mbështetet në gjykimin personal dhe në vlerat e grupit. Nëse ajo që keni ndërmend të bëni nuk është në përputhje me këto, duhet të pyesni veten pse ta bëni atë.



NËSE PËRGJIGJA PËR NJË NGA KËTO PYETJE ËSHTË JO, NDALU DHE NGRITE ZËRIN!

Nëse keni ndonjë shqetësim ose dyshim, kërkoni udhëzime nga një autoritet përkatës: Menaxheri juaj i linjës, menaxheri i lartë, Zyra Ligjore ose e Pajtueshmërisë.

— SI PËRPUTHET KODI ME LIGJET VENDORË DHE NDËRKOMBËTARE? —

Të gjithë punonjësit pritët të jenë të njohur me standardet ndërkombëtare dhe të jenë në pajtueshmëri me ligjet, rregullat dhe rregulloret në fuqi në të gjitha fushat, dhe me standardet profesionale që zbatohen për aktivitetet e tyre profesionale.

Për të siguruar stabilitetin e sistemit financiar, industria në të cilën ne punojmë është shumë e rregulluar. Të qenit i vetëdijshëm dhe respektimi i ligjeve dhe rregulloreve sipas të cilave operon Grupi nuk është vetëm një pjesë kritike e biznesit tonë, por thelbësore për atë që jemi. Ne synojmë të jemi në përputhje jo vetëm me përshkrimin e ligjit, por edhe me frymën dhe qëllimin e ligjit. Respektimi i ligjit është i padiskutueshëm. Përfshirja në veprime ose praktika të padrejta, mashtruese dhe abuzive do të ndikonte negativisht në besimin e klientit, do të vinte në rrezik reputacionin e Grupit dhe mund të rezultojë në kritika nga rregullatori, veprime ligjore, gjoba, ndëshkime dhe pasoja të tjera negative për Grupin.

Grupi BNP Paribas është i përkushtuar që gjithmonë të bashkëpunojë me organet rregullatore përkatëse.

Nëse keni ndonjëherë pyetje lidhur me ligjet dhe rregulloret që duhet zbatuar për aktivitetin tuaj ose për përgjigjen që t'i jepni një organi rregullator, kontaktoni zyrtarin tuaj të pajtueshmërisë, ligjor ose tatimor për ndihmë dhe këshilla.

Kodi i Sjelljes artikulon çka pritët nga secili prej nesh; d.m.th sjelljet më të mira, brenda kornizës ligjore dhe rregulloreve në fuqi në tregjet në të cilat Grupi bën biznes. Në rast të një konflikti të mundshëm në mes të legjislacionit kombëtar dhe rregullave të përfshira në Kod, Grupi BNP Paribas do të jetë i pajtueshëm me ligjet vendore në fuqi derisa përpiqet të identifikojë mënyrat e duhura për të zbatuar dhe respektuar rregullat në Kod. Kur një situatë kërkon interpretim nga punonjësit e Grupit, ajo duhet të bëhet në një mënyrë që të jetë në përputhje me kriteret më strikte etike të zbatueshme.

NGRITJA E ZËRIT DHE E SHQETËSIMEVE

Grupi BNP Paribas është shumë i vëmendshëm ndaj shqetësimeve të klientëve, furnizuesve, punonjësve, aksionarëve dhe komunitetit të gjerë. Grupi është i përkushtuar të dëgjojë, të kuptojë dhe të kërkojë trajtimin e shqetësimeve të ngritura nga akterët tanë në një mënyrë të drejtë dhe efektive.

Si punonjës, nëse jeni dëshmitar ose dyshoni për një shkelje të Kodit të Sjelljes, për shembull, vëreni trajtim të pabarabartë në mes të dy klientëve që përndryshe duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, ose mashtrim të brendshëm, ose ju dyshoni për një akt korrupsioni (përfshirë tregtinë e ndikimit) ose një praktikë antikonkurruese, ose jeni dëshmitar i një akti diskriminimi, ngacmimi, etj., duhet ta raportoni menjëherë.

DISA KANALE JANË TË DISPONUESHME PËR JU⁶:

Për të ngritur një shqetësim (sinjal), tani keni një platformë të vetme dhe të sigurt⁶ për mbledhjen e sinjalizimeve, nëse ato kanë të bëjnë me Respektin ndaj personave⁷ ose çdo lloj situatë tjetër⁸.

◆ Për një shqetësim në lidhje me Respektin për personat

Nëse po mendoni të ngrini një shqetësim, mund të dëshironi të diskutoni situatën me dikë sipas zgjedhjes suaj para se të përdorni platformën e vetme të sigurt.

Ky person mund të jetë menaxheri juaj ose ndonjë menaxher tjetër, "Partneri juaj i Burimeve Njerëzore" të PBBNJ-së dhe/ose një anëtar lokal i Burimeve Njerëzore, një korrespondent i Diversitetit, Barazisë dhe Përfshirjes ose – nëse ata ekzistojnë në vend – një staf mjekësor ose social, ose përfaqësues i stafit.

◆ Për një shqetësim për të gjitha llojet e tjera të situatave

Nëse planifikoni të ngrini një shqetësim përmes platformës, mund të zgjidhni në mesin e kanaleve të ndryshme⁹.

Ju gjithashtu mund t'i referoheni menaxherit tuaj të linjës (menaxherit tuaj të drejtpërdrejtë në baza ditore) ose një menaxheri të nivelit më të lartë në fushën tuaj të aktivitetit, nëse keni një problem të flisni me menaxherin tuaj të linjës.

Çdo situatë në kundërshtim me ligjet, rregulloret, Kodin e sjelljes, politikat ose procedurat e Grupit duhet të raportohet dhe do të trajtohet në mënyrë të paanshme, të pavarur dhe konfidenciale nga Referentët Sinjalizues të Pajtueshmërisë ose Referentët e BNJ-së për Sjellje lidhur me "Respektin për personat".

Ngritja e një shqetësimi është një e drejtë dhe asnjë punonjës nuk mund të sanksionohet, largohet nga puna ose diskriminohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për ngritjen e një shqetësimi në mirëbesim.

Konfidencialiteti i fakteve, identiteti i sinjalizuesit dhe identiteti i personave të synuar ruhen gjatë gjithë procesit.

Personat e përfshirë në trajtimin e shqetësimeve i nënshtrohen rregullave strikte të konfidencialitetit.

Asnjë punonjës nuk mund t'i nënshtrohet masave hakmarrëse për një shqetësim të bërë në mirëbesim. Kjo mbrojtje ofrohet edhe çdo punonjësi që ka dëshmuar apo ka dhënë prova për hetimet.

Një punonjës që mendon se është viktimë e hakmarrjes profesionale për shkak të ngritjes së një shqetësimi mund ta raportojë këtë situatë.

Asgjë këtu ose në politikat e tjera të BNP Paribas nuk ju ndalon të raportoni shkelje të mundshme të çdo ligji, rregulli ose rregulloreje te ndonjë agjenci ose subjekt qeveritar.

6 – Kjo platformë, e quajtur "BNP Paribas Whistleblowing Platform", është e qasshme përmes linkut në vijim: [EthicsPoint - BNP Paribas Group](#)

7 – Politika e Grupit për Respektimin e Personave RHG0063

8 – Korniza e Procedurës së Sinjalizimit në Grup CPL0038

9 – <https://echonet.bnpparibas/pages/5ddbdee47135fc36152b47a2>

PËRGJEGJËSI DHE LLOGARIDHËNIE SHTESË PËR MENAXHERËT

Menaxherët kanë për detyrë të jenë shembull dhe t'i përmbahen standardeve më të larta të sjelljes, ndërkohë që sigurojnë që ato standarde të jenë të qarta dhe transparente për ata që u raportojnë atyre.

ATA DUHET:

- ◆ të krijojë një atmosferë që inkurajon komunikimin e hapur, të ndershëm dhe të respektueshëm,
- ◆ t'ua komunikojnë përshkrimin dhe frymën e Kodit raportuesve të tyre dhe kolegëve të tjerë,
- ◆ ti përmbahen procedurave të Grupit për të përfshirë bashkërenditjen dhe respektimin e Kodit si një faktor në menaxhimin e performancës,
- ◆ ti kuptojnë në mënyrë aktive rreziqet e përfshira në punën e kolegëve të tyre dhe marrin një rol në sigurimin e cilësisë së punës së raportuesve të tyre,
- ◆ të japin një shembull për komunikim të ndershëm dhe të respektueshëm me klientët, kolegët dhe njerëzit e tjerë të lidhur me Grupin BNP Paribas, duke respektuar rregullat e zbatueshme të konfidencialitetit,
- ◆ të reagojnë në mënyrë efektive dhe të shpejtë ndaj çdo shqetësimi që është ngritur nga kolegët dhe ndërmerrni veprime të menjëhershme kur zbulohet ndonjë gabim ose sjellje e keqe.

SHTOJCA KUNDËR KORRUPSIONIT



PARANDALIMI,
ZBULIMI DHE LUFTIMI
I KORRUPSIONIT DHE
TREGTISË SË NDIKUAR

TABELA E PËRMBAJTJES SHTOJCA KUNDËR KORRUPSIONIT

A – Përkufizimi i sjelljeve të ndaluara që ka gjasë të interpretohen si ryshfet, korrupsion ose tregti e ndikuar	40
B – Parimet bazë për parandalimin, zbulimin dhe luftimi i korrupsionit dhe tregtisë së ndikuar	41
C – Ilustrimet e sjelljeve të ndaluara që ka gjasë të interpretohen si ryshfet, korrupsion ose tregti e ndikuar	42
◆ Konflikti i interesave	42
◆ Dhuratat, ftesat dhe argëtimet	44
◆ Pagesat për lehtësime	46
◆ Konfidencialiteti i të dhënave	47
◆ Filantropi, partneritet, sponsorizim dhe donacione e ndërlidhura	48
◆ Përfaqësimi i interesave (Lobimi)	50
◆ Punësimi (rekrutimi)	50
◆ Ilustrime të tjera në lidhje me klientët, furnizuesit, ndërmjetësuesit dhe palët e tjera të treta	52

Shtojca Kundër Korrupsionit në Kodin e Sjelljes së Grupit zbatohet për të gjithë punonjësit dhe Ekzekutivin e lartë të BNP Paribas, të cilëve u kërkohet të respektojnë të gjitha procedurat dhe kontrollet përkatëse në të gjitha rrethanat, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me sigurinë financiare dhe etikën profesionale (shih më lart për seksionet “Siguria financiare” dhe “Etika profesionale” të Kodit të Sjelljes së Grupit).

Shtojca Kundër Korrupsionit në Kodin e Sjelljes së Grupit është një dokument publik i qasshëm për të gjithë, duke përfshirë partnerët e BNP Paribas.



PËRKUFIZIMI I SJELLJEVE TË NDALUARA

QË KA GJASË TË INTERPRETOHEN SI RYSHFET, KORRUPSION OSE TREGTIM E NDIKUAR

Shtojca Kundër Korrupsionit në Kodin e Sjelljes së Grupit BNP Paribas përkufizon dhe ilustron sjelljet e ndaluara që ka gjasë të interpretohen si ryshfet, korrupsion ose tregtim me ndikim (në tekstin e mëtejme së bashku të referuara si “Korrupsion” ose veçmas si “korrupsion” dhe “tregtim me ndikim”).

KORRUPSIONI

Korrupsioni ekziston kur një person propozon, ofron, premtan, autorizon, aprovon, kërkon ose pranon, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për përfitimin e tij ose të një pale të tretë, një avantazh të paligjshëm për kryerjen, lehtësimin, mosveprimin ose vonesën e një veprimi brenda fushëveprimin e detyrave të tyre.

Për shembull, korruptuesi i ofron të korruptuarit pagesë me para të gatshme me qëllim të hapjes së një llogarie bankare.

Korrupsioni përfshin ndërveprimin e të paktën dy personave, qoftë fizikë apo juridikë, publikë apo privatë. Korrupsioni thuhet se është aktiv kur korruptuesi ofron një avantazh të paligjshëm, përderisa ka korrupsion pasiv kur personi i korruptuar pranon ose kërkon një avantazh të paligjshëm. Korrupsioni mund të jetë indirekt kur përfshin ose kur përfiton një palë të tretë ose një ndërmjetës.

Në një manifestim të vetëm të korrupsionit, aktet e korrupsionit aktiv dhe atij pasiv janë të dënueshme në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri (njëri mund të dënohet edhe nëse

tjetri nuk është i dëshmuar/karakterizuar). Së fundi, korrupsioni dënohet më ashpër kur kryhet nga një zyrtar publik.

TREGTIM ME NDIKIM

Tregtimi me ndikim ndodh kur një zyrtar publik¹ ofron, kërkon ose pranon ndonjë avantazh për të abuzuar me ndikimin e tyre real ose të perceptuar me qëllim që të marrë një vendim, autorizim ose situatë të favorshme nga një autoritet ose administratë publike.

Ashtu si korrupsioni, tregtimi me ndikim mund të jetë aktive (kur propozohet), ose pasive (kur kërkohet ose pranohet).

Përderisa personi i korruptuar vepron, ose përmbahet nga veprimi, duke kryer funksionet e veta, autori i tregtimit të ndikuar përdor ndikimin e tij mbi personin që ka fuqinë për të vepruar ose për të mos vepruar. Për shembull, tregtimi me ndikim konsiston në premtimin e diçkaje, jo që autori të kryejë veprime si pjesë e detyrave të tij, por më tepër të përdorë ndikimin e tij (real ose të perceptuar) me një palë të tretë për të marrë një vendim ose autorizim të favorshëm.

Punonjësit e Grupit BNP Paribas nuk duhet në asnjë rrethanë të marrin pjesë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në akte korrupsioni ose tregtie me ndikim, të cilat janë të ndaluara me ligj dhe sipas Shtojcës Kundër Korrupsionit të Kodit të Sjelljes së Grupit BNP Paribas.

Si institucion financiar, BNP Paribas gjithashtu mund të ekspozohet ndaj korrupsionit ose tregtisë me ndikim që përfshin një palë të tretë. Punonjësit nuk duhet ta vënë Bankën në rrezik për t'u përfshirë në transaksione korrupsioni dhe/ose pastrim parash.

Punonjësit e Grupit BNP Paribas nuk duhet në asnjë rrethanë të marrin pjesë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në akte korrupsioni ose tregtie me ndikim, të cilat janë të ndaluara me ligj dhe sipas Shtojcës Kundër Korrupsionit të Kodit të Sjelljes së Grupit BNP Paribas.

Si institucion financiar, BNP Paribas gjithashtu mund të ekspozohet ndaj korrupsionit ose tregtisë me ndikim që përfshin një palë të tretë. Punonjësit nuk duhet ta vënë Bankën në rrezik për t'u përfshirë në transaksione korrupsioni dhe/ose pastrim parash.

1- Një zyrtar publik përkufizuar sipas Udhëzuesit Wolfsburg ABC dhe aty ceket si minimum çdo person që:

- merr ose mban një detyrë ose funksion publik, veçanërisht të zgjedhur, politik, administrativ, gjyqësor ose monarkist, në një vend, qoftë i emëruar ose i zgjedhur (nëpunës civil, përfaqësues i zgjedhur lokal, kandidat për post politik, punonjës ose zyrtar i një partie politike, deputet, gjykatës, etj.) ose të trashëguar (familjet mbretërore)

- kryen një funksion publik për një vend, duke përfshirë një ndërmarrje publike, organ publik, subjekt shtetëror ose të kontrolluar nga shteti

- i përket një organizate ndërkombëtare publike

- belongs to a public international organization

B

PARIMET BAZË PËR PARANDALIMIN, ZBULIMIN DHE LUFTIMI I KORRUPSIONIT DHE TREGTISË SË NDIKUAR

Për BNP Paribas, Korrupsioni është absolutisht i papranueshëm, pavarësisht nga rrethanat. Grupi BNP Paribas është në përputhje me ligjin 'Sapin II' të 9-të dhjetori 2016 në lidhje me transparencën, luftën kundër korrupsionit dhe modernizimin e ekonomisë, si dhe Ligjit për Ryshfetit në Mbretërinë e Bashkuar, Ligjin e Praktikave Korruptive të Jashtme të SHBA-ve (FCPA) dhe ligje të tjera në fuqi.

Grupi BNP Paribas ka zbatuar një kornizë globale për të parandaluar, zbuluar dhe luftuar korrupsionin² që përbëhet nga masat dhe procedurat në vijim:

◆ Deklarata e CEO (Kryeshefit ekzekutiv) të Grupit kundër korrupsionit duke konfirmuar zero tolerancën të BNP Paribas për korrupsionin dhe tregtimin e ndikimit, të qasshme për të gjithë³,

◆ Një qeverisje e mbikëqyrur nga një ekip i përkushtuar në nivel Grupi, dhe i mbështetur nga një rrjet ndërkom-bëtar korrespondentësh kundër korrupsionit,

◆ Një kornizë për zbulimin dhe parandalimin e korrupsionit, e krijuar në formën e një harte të rrezikut, e cila përditësohet rregullisht,

◆ Procedurat që vendosin kërkesat për klientët, ndërmjetësuesit, furnizuesit ose llojet e tjera të kujdesit të shtuar të palëve të treta,

◆ Kodi i Sjelljes përfshirë Shtojcën Kundër Korrupsionit,

◆ Trajtime dhe fushata ndërgjegjësimi,

◆ Një sistem sinjalizues,

◆ Një regjim disiplinor në rast të shkeljeve nga punonjësit,

◆ Krijimi i kontrollit të brendshëm (përfshirë kontrollet e kontabilitetit) dhe monitorimi i treguesve të rrezikut dhe performancës.

Grupi BNP Paribas, drejtuesit e lartë të tij dhe të gjithë punonjësit e tij duhet të kenë zero tolerancë ndaj korrupsionit dhe ta luftojnë atë në mënyrë aktive. Prandaj, çdo formë e korrupsionit është plotësisht e ndaluar dhe duhet të raportohet: p.sh., Korrupsioni i cili përfshin punonjësit (qoftë për përfitime personale, ose për Grupin) si dhe Korrupsioni që përfshin klientët ose partnerët tanë, për të cilin ne mund të kuptojmë në kontekst të një transaksioni të Grupit BNP Paribas ose aktiviteteve tona.

Pjesëmarrja ose përfshirja në korrupsion konsiderohet si sjellje joadekuate profesionale. Çdo punonjës që sillet në kundërshtim me Shtojcën Kundër Korrupsionit të Kodit të Sjelljes së Grupit BNP Paribas është përgjegjës për masat disiplinore, pa paragjykuar ndjekjen penale.

Në çfarëdo rrethane dhe çfarëdo interes të biznesit që është në pyetje, parandalimi dhe zbulimi i Korrupsionit është përgjegjësi e të gjithëve.

Punonjësit e BNP Paribas pritët të përmbahen nga pjesëmarrja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë në korrupsion dhe, si detyrë profesionale, të bëjnë gjithçka në fuqinë e tyre për të ndihmuar në parandalimin ose ndalimin e korrupsionit.

A keni ndonjë pyetje lidhur me shtojcën kundër korrupsionit? Ju lutemi kontaktoni menaxherin tuaj të linjës ose zyrën e Pajtuëshmërisë/korrespondentin tuaj kundër korrupsionit.

2 – Përmbledhja e masave kundër korrupsionit të BNP Paribas në linkun në vijim: https://cdn-group.bnpparibas.com/uploads/file/summary_of_bnp_paribas_global_anti_corruption_policy_and_program_january_2025.pdf

3 – Deklarata kundër korrupsionit nga Kryeshefi Ekzekutiv, e disponueshme në linkun në vijim: [Scanned document \(bnpparibas.com\)](#)

C

ILUSTRIMI I SJELLJEVE
TË NDALUARAQË KA GJASË TË INTERPRETOHEN
SI KORRUPSION OSE TREGTI E NDIKUAR

Çdo punonjës i cili është nën presion ose ka bazë të arsyeshme për të besuar se një situatë për të cilën ata janë të vetëdijshëm, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nuk përputhet me një ose më shumë nga parimet e përcaktuara në shtojcën kundër korrupsionit ose me procedurat dhe politikat e Grupit, duhet ta raportojnë atë sa më shpejt të jetë e mundur te menaxheri i tyre i linjës ose zyra e Pajtuëshmërisë.



KONFLIKTI I INTERESAVE

Nëse nuk është e mundur përmes këtyre kanaleve, punonjësi mund të përdorë kanalin e sinjalizimit me konfidencialitetin më të rreptë, siç organizohet nga procedura e kornizës së sinjalizimit të Grupit BNP Paribas (e qasshme nga Baza e të Dhënave të Procedurave). Sinjalizues që raporton në mirëbesim një shkelje të Shtojcës Kundër Korrupsionit nuk do t'i nënshtrohet hakmarrjes. Sinjalizuesi mbrohet me ligj dhe nga sistemi i sinjalizimit të Grupit BNP Paribas.

Çdo palë e tretë – klientë, partnerë, furnizues, ndërmjetësues, të tjerë – që bën kërkesa të padrejta ose korruptive gjatë ndërveprimit të tyre me Grupin BNP Paribas, inkurajohet të raportohet sa më shpejt të jetë e mundur (shih më lart, për seksionin “Të Ngrini Zërin dhe Shqetësimet” të Kodit të Sjelljes së Grupit).

Punonjësit duhet të ndjekin rregullat e brendshme për zbulimin, parandalimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit privat, ashtu që të parandalojnë një interes personal që të ndikojë në mënyrë korruptive ose gabimisht në veprimet ose vendimet e tyre (shih më lart, për “Parandalimin dhe shmangien e konflikteve të interesave në mandate dhe interesat e jashtme të biznesit” seksioni i Kodit të Sjelljes së Grupit, dhe procedurat në lidhje me konfliktin e interesave, të qasshme përmes Bazës së të Dhënave të Procedurave).



Po kaloj një periudhë të vështirë në jetën time private dhe një nga klientët e mi është ofruar të më huazoj para. Jam tunduar t'i pranoj, sepse kemi një marrëdhënie besimi dhe sigurisht që do t'ia kthej ato.

A mund ta pranoj ofertën e klientit tim?

Ndalohet marrja e parave nga klientët (ose nga çdo palë ose partner tjetër i BNP Paribas), pasi kjo mund t'ju ekspozojë ndaj një situatë korrupsioni dhe konflikti interesash, andaj kjo edhe rrjedhimisht krijon vështirësi në kryerjen e detyrave tuaja profesionale në mënyrë të paanshme. Ju duhet ta refuzoni këtë propozim dhe të informoni menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtuëshmërisë.



Jam emëruar për të përzgjedhur një furnizues të energjisë së gjelbër për objektet e reja, megjithëse jam përfaqësues i njërës prej kompanive ofertuese.

Çfarë duhet të bëj?

Mos merrni pjesë në procesin e përzgjedhjes për të shmangur ndonjë konflikt interesi dhe informoni menaxherin tuaj të linjës. Të gjitha ofertat do të shqyrtohen si pjesë e procedurave të Prokurimit.”



Një nga klientët e mi më ka ofruar apartamentin e saj personal në një resort bregdetar, pa pagesë (dhe në konfidencialitet të plotë!) për pushimet e mia. Megjithatë, unë jam vendimmarrësi për të gjitha llogaritë dhe produktet dhe shërbimet e saj bankare.

A mund ta pranoj këtë ftesë?



Një person i njohur për mua, i cili është një Drejtues i Lartë në një kompani që unë e njoh mirë, më ka treguar në fshehtësi sekretin e procesit të shitjes së një prej konkurrentëve tanë: nuk mund ta humbisni këtë mundësi, ai më tha, pasi ata po e kërkojnë një blerës! Megjithatë, kujdesi i shtuar për kompaninë e synuar zbuloi se gruaja e personit të njohur për mua është një nga aksionarët kryesore.

A ka kjo rëndësi?

Po: personi i njohur për ju është në konflikt dhe duke marrë parasysh marrëdhënien tuaj, ka gjasë të jeni edhe ju. Shtesë kësaj, personi i njohur për ju ka dhënë informata konfidenciale, gjë e cila ka gjasë të interpretohet si një avantazh i paligjshëm (shih më poshtë). Informoni menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtuëshmërisë dhe mos merrni pjesë në procesin e vendim-marrjes.”

Jo, ju duhet ta refuzoni këtë propozim, i cili do t’ju ekspozonte ndaj një konflikti interesash dhe mund të ndikojë në mënyrë korruptive në vendimet tuaja të ardhshme në lidhje me këtë marrëdhënie biznesi dhe/ose të perceptohet si korruption. Informoni menjëherë menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtuëshmërisë.”

DHURATAT, FTESAT DHE ARGËTIMET

Dhuratat dhe ftesat e arsyeshme janë pjesë e rrjedhës së zakonshme të biznesit, me kusht që ato të ofrohen ose pranohen në kuptim të mirësjelljes ose për qëllime të promovimit të biznesit, dhe pa qëllim për të ndikuar në mënyrë korruptive ose të padrejtë te pranuesi. Vlera monetare, shpeshtësia dhe, në përgjithësi, rrethanat në të cilat dhuratat dhe ftesat mund të pranohen ose ofrohen janë të kufizuara për të parandaluar që ato të përbëjnë ose të perceptohen si një shpërblim për një avantazh të paligjshëm ose si kusht për të ushtruar ndikim.

Prandaj, respektimi i politikave të brendshme për dhurata, ftesa dhe argëtim të Grupit BNP Paribas është i detyrueshëm (shih më lart, për seksionin “Etika Profesionale” të Kodit të Sjelljes së Grupit dhe procedurën e dhuratave dhe ftesave⁴, të qasshëm nga Baza e të Dhënave të Procedurave) si dhe dhënia e deklaratave të kërkuara.

Sido që të jenë rrethanat dhe çfarëdo mënyre të pagesës, punonjësit e BNP Paribas nuk duhet të pranojnë dhe as t’u japin para palëve të treta. Të gjitha pagesat dhe shpenzimet duhet të jenë të ligjshme, të justifikuar, të miratuara dhe të regjistruara në llogari. Punonjësit nuk duhet t’i vënë në dispozicion pasuritë e Grupit BNP Paribas pa autorizimin e duhur.



Sa herë që ai viziton degën tonë, klienti im këmbëngul të lërë një zarf të vogël me disa kartëmonedha në tryezën time.

Çfarë duhet të bëj?

Ju duhet ta refuzoni: çdo dhuratë të parave është e ndaluar, pavarësisht nga shuma, qoftë edhe me mirësjellje. Raportoni refuzimin tuaj te menaxheri i linjës dhe te zyra e Pajtuëshmërisë dhe regjistroni atë në regjistrin përkatës.



Sot në mëngjes, mora një pako nga një furnizues me tableta të gjeneratës së fundit, nga një për secilin anëtar të komisionit tim.

A mund t’i mbaj ato?

Jo, ju duhet t’i refuzoni dhe t’i ktheni këto tableta të cilat ka gjasë të ndikojnë në gjykimin tuaj në mënyrë korruptive ose të gabuar lidhur me këtë furnizues, aq më tepër që vlera e tyre tejkalon kufijtë monetarë. Ju gjithashtu duhet ta informoni menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtuëshmërisë dhe të rivlerësoni integritetin e këtij furnizuesi me Prokurimin.

4 – Përmbledhja ekzekutive e Procedurës së Dhuratave dhe Ftesave të Grupit BNP Paribas është e disponueshme në: [exec_summary_bnpp_gi_procedure_v_en_review_ep_june_2024.pdf \(bnpparibas.com\)](https://www.bnpparibas.com/en/procurement/summary-bnpp-gi-procedure-v-en-review-ep-june-2024.pdf)



Duke qenë plotësisht i kënaqur me kredinë e re që sapo i është dhënë, klienti im më ofroi orën digjitale të gjeneratës së fundit.

Çfarë duhet të bëj?

Ktheni këtë dhuratë me mirësjellje dhe informoni menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtueshmërisë. Çdo dhuratë që nuk mund të kthehet do t'i jepet një organizate jofitimprurëse.



Koha dhe vendi i përsosur për të ftuar Menaxherin e Blerjeve të klientit tonë, tha kolegu im: ky restorant sapo ka fituar yllin e tij të 3-të! Gjithçka që na duhet për të siguruar rinovimin e kontratës!

A është kjo e lejuar?

Ftesat nuk mund të përdoren në mënyrë korruptive me qëllim të avantazhit të paligjshëm. Informoni menaxherin tuaj të linjës, zyrën e Pajtueshmërisë dhe të Prokurimit.



Unë dhe kolegu im kemi pranuar një kuti me shishe shampanjë, nga i njëjti blerës.



Pse të mos i pranosh këto bileta "Pako të Mikpritjes", më pyeti ky furnizues? Ju jeni gjithashtu sponsor i këtij eventi sportiv, ndaj nuk ka nevojë të hezitoni më, ne do të vazhdojmë festimet në mbrëmje!

A hezitoj me drejtë që t'i pranoj këto dhurata dhe ftesa?

Gjithmonë shikoni politikat e dhuratave dhe ftesave për të parë nëse mund t'i pranoni ato duke pasur parasysh rrethanat, në përputhje me kërkesat e deklarimit dhe informoni menaxherin tuaj të linjës, zyrën e Pajtueshmërisë dhe Prokurimit kur vjen nga një furnizues.

PAGESAT PËR LEHTËSIME

Pagesat për lehtësime janë ryshfete të vogla të paguara zyrtarëve publikë për të lehtësuar veprimet rutinore.

Është e ndaluar për punonjësit të japin para, pavarësisht nga shuma, për zyrtarët publikë për përshpejtimin ose lehtësimin e procedurave administrative, apo për t'u pajisur me autorizime si licenca, leje, etj.

? Fluturimi im sapo ka ateruar me katër orë vonesë. Dhjetëra pasagjerë janë në radhë për të marrë vizën e nevojshme të hyrjes dhe tani do të jem vonë për një takim me një klient të rëndësishëm. Një zyrtar i Emigracionit më jep një shenjë të qartë se dhënia e disa kartëmonedhave do të shkurtonte kohën e pritjes.

? Zyrtari përgjegjës për dhënien e lejes për rinovimin e objekteve tona të biznesit më kontaktoi: kërkesa jonë është aktualisht në fund të grumbullit... por mund të bëhet prioritet në këmbim të një zarfi të vogël.

Çfarë duhet të bëj në këto situata?

Ju duhet t'i refuzoni këto propozime sepse pagesat e lehtësimeve janë të ndaluara. Informoni menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtuësshmërisë.

? Klienti im ka nevojë për disa leje dhe autorizime publike për të nisur projektin e tij të ri të infrastrukturës. Megjithatë, ato janë vonuar dhe klienti im tani është i brengosur. Ai filloi të më bënte presion për ta përshpejtuar këtë çështje.

Çfarë mund të bëj?

Pagesat për lehtësime janë të ndaluara, duke përfshirë në bazë të kërkesës së klientit, dhe pavarësisht nga interesi i biznesit në fjalë. Informoni menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtuësshmërisë.

KONFIDENCIALITETI I TË DHËNAVE

Punonjësit në asnjë rrethanë nuk guxojnë të zbulojnë informata që i përkasin Grupit BNP Paribas ose marrëdhënieve të tij të biznesit, *a fortiori* në këmbim të një avantazhi ose shpërblimi të paligjshëm. Ngjashëm, punonjësit nuk guxojnë në asnjë rrethanë të komunikojnë ose të kërkojnë informata konfidenciale lidhur me një projekt, transaksion, konkurrent, palë të tretë, etj., me qëllim të përfitimit ose sigurimit të një avantazhi ose shpërblimi të paligjshëm.

Shih më lart, seksionin “Mbrotjtja e grupit” të Kodit të Sjelljes së Grupit, si dhe procedurat lidhur me privatësinë e të dhënave dhe informatave konfidenciale, të qasshme nga Baza e të Dhënave të Procedurave.



Një praktikante më informoi se një nga personat e njohurit për të i ofroi një pagesë në para në këmbim të informatave në lidhje me portofolin e klientit tim.

Çfarë mund të bëj?

Zbulimi i informatave lidhur me klientin është rreptësisht i ndaluar, veçanërisht në lidhje me llogaritë e tyre ose mjetet e pagesës, *a fortiori* në këmbim të një shpërblimi. Kërkojini praktikantit të refuzojë këtë propozim, informoni menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtueshmërisë, dhe Burimet Njerëzore.



Me investim në “gjelbër”, klienti im do të diversifikojë aktivitetet e tij: që do të thotë ka gjasë që gjithnjë e më pak të ketë biznes për Bankën... përveç nëse klienti merr fshehurazi informata konfidenciale për konkurrentët e tij.

A jam i autorizuar të ndaj informata konfidenciale me klientin tim për të ruajtur ose zhvilluar biznesin për Bankën?

Është rreptësisht e ndaluar, në asnjë rrethanë, që t’i zbulohen informatat konfidenciale një pale të tretë, veçanërisht informata lidhur me një klient ose partner tjetër të Grupit, *a fortiori* në këmbim për një avantazh ose shpërblim të paligjshëm.



Një konsulent i jashtëm, i cili aktualisht punon për partnerin e biznesit që unë po përpiqem të përfshi me produkte të reja, tha se mund të më ndihmojë duke ndarë informata të caktuara konfidenciale në lidhje me partnerin e biznesit... në këmbim të një detyre të re me Bankën.

Çfarë të bëj?

Ju duhet ta refuzoni këtë propozim dhe të informoni menaxherin tuaj të linjës, zyrën e Pajtueshmërisë dhe Prokurimin.



Një asistent i jashtëm, i punësuar për të më ndihmuar në një thirrje të madhe për tenderë, më ofroi të zbulonte informata konfidenciale për konkurrentët tanë: gjithçka që duhet të bëj është të rris faturat e tij.

Çfarë përgjigje duhet ti jap?

Në këtë rast, refuzoni këtë propozim dhe të informoni menaxherin tuaj të linjës, zyrën e Pajtuëshmërisë dhe Prokurimin.



FILANTROPI, PARTNERITET, SPONSORIZIM DHE DONACIONE E NDËRLIDHURA

Qëllimi i bamirësive, filantropive, donacioneve dhe sponsorizimeve në favor të organizatave shoqërore ose me interes të përgjithshëm (shoqata kulturore ose sportive, organizata humanitare) mund të keqpërdoret gabimisht dhe/ose në mënyrë korrupitive si një mënyrë për të kanalizuar një ryshfet, ose për të marrë një avantazh ose shpërblim, ose fonde të paligjshme. Prandaj, respektimi i procedurave të Filantropisë, Partneritetit dhe Sponsorizimit dhe NjK, të qasshme nga Baza e të Dhënave të Procedurave, është i detyrueshëm.

Në asnjë rrethanë nuk mund të kërkohen ose jepen donacione për filantropi, partneritet dhe sponsorizim si kusht për të ushtruar ndikim, ose për të marrë një avantazh ose shpërblim të paligjshëm për Grupin BNP Paribas, punonjësit ose partnerët e tij. Në veçanti, një donacion për një fondacion që i përket një Personi të Ekspozuar Politikisht ose një ndërmjetësuesi të lidhur me ta në kontekstin e lidhjes së një kontrate lokale, duhet t'i nënshtrohet një vigjilence të veçantë dhe kujdesit të shtuar. Ndonjë dyshim apo shqetësim? Ju lutem kontaktoni menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtuëshmërisë.



Sot në mëngjes, gazetat njoftuan se fondacioni për ndihmë mjedisore që është identifikuar për aksionin tonë të radhës filantropik është përfshirë në një skandal korrupsioni.

Çfarë duhet të bëj?

Ju duhet ta pezulloni transaksionin derisa të vlerësoni ndershmërinë e fondacionit në bazë të këtij lajmi negativ, së bashku me zyrat e Pajtuëshmërisë dhe të Komunikimeve.



Jam i shqetësuar: media ka raportuar një skandal të paprecedentë që prek një klient, fondacioni i të cilit duket se ka kryer pagesa për politikanë për vite me radhë.

Çfarë duhet të bëj?

Informoni menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtuëshmërinë për këtë lajm negativ dhe zbatoni procedurat Njih Klientin Tuaj (*Know Your Client*) në këtë marrëdhënie.



Çfarë perspektiva të mrekullueshme do të ishin të miat nëse do të fitonim tenderët për thirrjen e pronave të bërë nga komuna për projektin e saj të ri të zhvillimit social dhe të gjelbër! Në fakt, një zyrtar i komunës më ka bërë të kuptoj se mund të mbështetem në përkrahjen e tij të pakufizuar në këmbim të një donacioni për ekipin e volejbollit nga qyteti.

A më lejohet të pranoj?

Jo, filantropia, partneriteti dhe sponsorizimi nuk mund të përdoren në mënyrë korruptive për të marrë vendime të favorshme, veçanërisht nga zyrtarët publikë, apo ndonjë avantazh tjetër. Informoni menaxherin tuaj dhe zyrën e Pajtuëshmërisë.



Për ta bërë realitet ëndrrën e tij të filmit të ardhshëm, një producent ekzekutiv i kërkoi Bankës sponsorizim: pa dyshim, filmi do të jetë një hit! Sigurisht, ai nuk do ta harrojë mbështetjen time: unë dhe familja ime do të jemi të ftuar “all inclusive” në festivalin e ardhshëm ndërkombëtar të filmit dhe do të qëndrojmë në hotelin më të mirë të qytetit.

A mund të pranoj?

Jo, sponsorizimi duhet të zgjidhet në përputhje me procesin dhe procedurat e Komunikimit, pavarësisht nga çdo shpërblim. Informoni menaxherin tuaj, zyrën e Pajtuëshmërisë dhe Komunikimit, si dhe procedoni me deklaratat e kërkuara.



PËRFAQËSIMI I INTERESAVE (LOBIMI)

Përfaqësimi i interesave ose Lobimi përbën ofrimin e informatës për vendimmarrësit publikë me qëllim të 'ushqyerjes' dhe ndikimit në vendimet e tyre në lidhje me përmbajtjen e një ligji ose akti rregullator. Megjithatë, presioni ose shpërblimi i paligjshëm me qëllim të ndikimit korruptiv ose marrjes së një mendimi/vendimi të favorshëm – veçanërisht ato individuale – mund të interpretohen si Korrupsion.

Prandaj, në kontekstin e përfaqësimit të interesave të korporatës BNP Paribas, marrëdhëniet me vendimmarrësit publikë duhet të kryhen ekskluzivisht nga punonjës të autorizuar, të identifikuar në politika, të qasshme nga Baza e të Dhënave të Procedurave.

Së fundmi, janë të ndaluara donacionet apo subvencionet për partitë apo komitetet politike, apo në favor të politikanëve, nga subjektet e BNP Paribas apo për llogari të tyre.



Ky projektligj i ri do të ndikojë gjerësisht në profesionin tonë pa i shërbyer interesave tona... Mos u brengosni: Unë njoh vendimmarrësin publik që ka një rol vendimtar në miratimin e tekstit. Me siguri, mund ta bind që të ndryshojë dispozitat e projektligjit në këmbim të një fundjave të gjatë buzë detit. ...Meqë ra fjala, a lejohet kjo ofertë?

Jo. Ndalohet ofertë vendimmarrësve publikë me qëllim që të ndikojë në mënyrë korruptive tek ata për të marrë opinione ose vendime të legjislacionit ose rregullores preferenciale, pavarësisht se për çka bëhet fjalë.

PUNËSIMI (REKRUTIMI)

Në asnjë rrethanë nuk mund të jepet ose refuzohet punësimi në këmbim të një avantazhi të paligjshëm, ose si kusht për të ushtruar ndikim.

Punësimi drejtohet nga procedurat e Burimeve Njerëzore të Grupit BNP Paribas, të qasshme nga Baza e të Dhënave të Procedurave, të cilat duhet të zbatohen në të gjitha rrethanat.



Aktualisht i punësuar për një detyrë gjashtëmujore, një konsulent i jashtëm ka kërkuar ndihmën time për të marrë një pozicion me orar të plotë brenda Grupit. Ai premton, në këmbim, të më japë një përqindje të pagës së tij të ardhshme. Çfarë duhet të bëj?

Refuzoni këtë propozim dhe të informoni menaxherin tuaj të linjës, zyrën e Pajtueshmërisë dhe Burimet Njerëzore.

? Një partner biznesi i kamotshëm më premtan se do të zhvillojë biznesin e tij me Bankën nëse pranoj të i siguroj një praktikë për djalin e tij, i cili sapo ka mbaruar një universitet prestigjioz.

? Ju kontaktoheni nga një politikan i cili ju kërkon të rekrutoni nipin e tij. Të dy do t'ju jenë shumë mirënjohës.

A mund ti pranoj këto rekrutime?

Në të dyja situatat, kërkonin nga kontakti juaj të ndjekë procesin e rregullt të rekrutimit, të menaxhuar nga Burimet Njerëzore. Gjithashtu informoni menaxherin tuaj të linjës, zyrën e Pajtueshmërisë dhe Burimet Njerëzore, duke u ofruar atyre rrethanat dhe kërkesat që lidhen me këto aplikacione.

”

? Një kompani vlerësimi me të cilën kam punuar më parë, sugjeron miratimin e nënvlerësimit të çmimit të rishitjes së traktorëve bujqësorë, në këmbim të punësimit të vajzës sime – e sapodiplomuar, që kërkon punën e saj të parë në këtë sektor – rekrutim.

A mund ta përdor fuqinë time vendimmarrëse për të ndihmuar një të afërm të rekrutohet nga një palë tjetër e BNP Paribas?

Jo: ju duhet të respektoni rreptësisht proceset dhe procedurat e rimarketimit dhe të përzgjedhjes së partnerëve dhe duhet të përmbaheni nga keqpërdorimi i pushtetit tuaj të vendimmarrjes. Informoni menaxherin tuaj të linjës, zyrën e Pajtueshmërisë dhe Prokurimin, lidhur me rrethanat e kësaj kërkesë.

”

ILUSTRIME TË TJERA NË LIDHJE ME KLIENTËT, FURNIZUESIT, NDËRMJETËSUESIT DHE PALËT E TJERA TË TRETA

Klientët, furnizuesit dhe ndërmjetësuesit vlerësohen⁵ sa i përket rreziqeve të korrupsionit që ato mund të përfaqësojnë ose bartin d.m.th. në përputhje me faktorëve me rrezik të lartë të përcaktuar nga ligjet, rregulloret dhe autoritetet: për shembull, sektorë të caktuar të veprimtarisë ose vende, Personat e Ekspozuar Politikisht, lloje të caktuara transaksionesh si bashkimet dhe blerjet, etj.

Prandaj, punonjësit duhet të sigurojnë që procedurat e vlerësimit dhe monitorimit nga palët e treta ("Njihni tëndin") zbatohen në të gjitha fazat e marrëdhënies së biznesit dhe se ata ndjekin politikën kundër korrupsionit në përputhje me detyrimet e Grupit BNP Paribas, veçanërisht

duke përshtatur dokumentacionin kontraktual aty ku e zbatueshme (klauzolat kundër korrupsionit, klauzolat e ndërprerjes, etj.). Për më tepër, punonjësit duhet të përdorin mostrat e kontratave të BNP Paribas, të respektojnë procedurat e tenderit dhe të përmbahen nga përdorimi i ofruesve të shërbimeve të pamiratuara.

Punonjësit nuk duhet të hyjnë në një marrëdhënie biznesi ose kontratë ose angazhim, të ofrojnë ose të japin tarifa ose komisione të padrejta, ose një produkt ose shërbim, në këmbim të një shpërblimi ose një avantazhi të paligjshëm ose si kusht për të ushtruar ndikim.

KLIENTËT

Punonjësit nuk duhet të hapin një llogari, të japin një kredi ose të ofrojnë financim, ose ndonjë produkt ose shërbim tjetër të Grupit BNP Paribas, me qëllim përfitimin e një shpërblimi, marrjen ose ofrimin e një avantazhi

të paligjshëm, qoftë për qëllime biznesi ose personale (shih "Njih klientin tënd" politikat e qasshme nga Baza e të Dhënave të Procedurave).

? **Një klient që takova në klubin e tenisit më tregoi për përpjekjet e tij të pasuksesshme për të marrë një kredi për një nga kompanitë e tij dhe më pyeti se sa do të kushtonte një "dorë ndihmëse".**

? **Një klient kërkon një financim me normë të ulët: Në këmbim, unë do të përfitoj nga një ridhënie e komisionit.**

? **Kur personi dëgjoi se unë nuk do të hap llogarinë e tij bankare, ai më propozoi t'i drejtohesha kërkesave të politikave, në këmbim të një zarfi.**

? **Derisa po rishikonim gjendjen negative të llogarisë së tij, një klient i vjetër shpjegoi se po kalonte një periudhë të vështirë. Nëse pranoj të vërtetoj mbitërheqjen e tij pa pagesë, do të marr një pishinë me një çmim të volitshëm.**

Çfarë duhet të them?

Ju duhet t'i refuzoni këto kërkesa të papranueshme që janë në kundërshtim me politikat e Grupit BNP Paribas dhe t'i deklaroni ato menaxherit tuaj të linjës dhe zyrë së Pajtureshmërisë, dhe të rivlerësoni ndershmërinë e klientit.

5 – Prezantimi i kornizës së përgjithshme të Njih Klientin Tuaj, Ndërmjetësuesin dhe Furnizuesin e BNP Paribas, i qasshëm nga: [2024-juin-resume-procedures-kyc-kyj-kyj-vf-fr.pdf \(bnpparibas.com\)](https://bnpparibas.com/2024-juin-resume-procedures-kyc-kyj-kyj-vf-fr.pdf)



Një klient që punon në një sektor të ndjeshëm njofton një transferim të konsiderueshëm fondesh për të shlyer shumën e bilancit të një kontrate të lidhur me një kompani të vendosur në një vend në rrezik korrupsioni, i cili është subjekt i lajmeve negative. Shuma e transferimit duket më e lartë në krahasim me kontratën. Sipas klientit tim, diferenca është për shkak të “shpenzimeve të ndryshme” në favor të pronarit të kompanisë së huaj.

A mund t’i zbatoj këto udhëzime?

Për të shmangur përfshirjen në realizimin e një akti korrupsioni, pezulloni transaksionin, zbatoni procedurat e sigurisë financiare dhe informoni menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtuëshmërisë.



Klienti im sapo ka hapur një filiale të re në një vend të ndjeshëm nga perspektiva e korrupsionit. Rrjedhimisht, ai urdhëroi një transaksion të konsiderueshme parash në favor të vajzës së presidentit të atij vendi, pa asnjë shpjegim të qartë.

Çfarë duhet të bëj?

Ju duhet ta raportoni këtë transaksion të dyshimtë te menaxheri juaj i linjës dhe zyra e Pajtuëshmërisë.



Klienti im fitoi një kontratë të madhe jashtë vendit dhe më pas më udhëzoi të transferoja një shumë të konsiderueshme në favor të një fondacioni, të regjistruar në një parajsë fiskale dhe që i përket ndërmjetësuesit që punon për klientin tim homolog publik.

Çfarë duhet të bëj?

Pezulloni këtë transaksion dhe zbatoni procedurat e vlerësimit. Informoni menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtuëshmërisë.



Në mungesë të rrjedhës së parave të gatshme dhe në pamundësi për të kthyer kredinë e tij, klienti im më ofron një “alternativë të thjeshtë”: dhënien e një fshirjeje që i lejon ata të shlyejnë një herë e përgjithmonë borxhet e tyre, në këmbim të një ndarjeje “50-50” me mua.

Çfarë duhet të bëj?

Ju nuk mund ta pranoni këtë propozim: debitori (klienti) do të përfitonte në mënyrë korruptive nga fshirja nëse është e paligjshme. Ju duhet ta raportoni këtë propozim te menaxheri juaj i linjës dhe zyrës së Pajtuëshmërisë.

FURNIZUESIT

Integriteti i furnitorëve është një kusht 'sine qua non' për të punuar me Grupin BNP Paribas⁶. Prandaj, punonjësit duhet të mbrojnë reputacionin e Grupit nga çdo veprim që cenon integritetin duke zbatuar procedurat e Prokurimit të disponueshme në Bazën e të Dhënave të Procedurave.

Shih gjithashtu më lart, seksionin "Mbrotja e Grupit" të Kodit të Sjelljes së Grupit BNP Paribas, si dhe procedurat "Njih Furnizuesin Tënd", të qasshme nga Baza e të Dhënave të Procedurave.

? Gjatë një thirrje për tender, një nga kompanitë ofertuese më kontakton: nëse pranoj të ndihmoj përzgjedhjen e saj, do të më japë një kthim 5% të faturave të ardhshme.

? Menjëherë pas shpalljes së thirrjes për tenderat për një ndërtim, një nga furnizuesit ofertues më kontaktoi: Do të kem një kuzhinë krejt të re në këmbim të zgjedhjes së saj!

? Një furnizues, i cili e njeh shumë mirë menaxherin tim, ofron të testojë zgjidhjen tonë të re falas: gjithçka që duhet të bëj është ta punësoj atë dhe të përgatitem për pagesë!

Çfarë duhet të bëj?

Në cilindo rast, ju duhet të refuzoni dhe të njoftoni menjëherë menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtuëshmërisë, si dhe Prokurimin, në mënyrë që integriteti i furnizuesit të mund të rivlerësohet.

NDËRMJETËSUESIT

Ashtu si të gjithë homologët e BNP Paribas, ndërmjetësuesit i nënshtrohen kujdesit të shtuar dhe kontrolleve (shih procedurën e Grupit Njih Ndërmjetësuesin Tuaj, e qasshme nga Baza e të Dhënave të Procedurave).

? Kohët e fundit, shitjet e brokerit tim janë ulur. Pasi më ftoi në një fushë golfi, ai më shpjegoi se do të ishte më i motivuar se kurrë dhe do t'i jepte përparësi absolute shitjes së produkteve të mia, në këmbim me një rritje të marzhit.

Si duhet t'i përgjigjem atij?

Ju duhet ta refuzoni me vendosmëri këtë kërkesë dhe të informoni menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtuëshmërisë në mënyrë që të rivlerësoni integritetin e këtij ndërmjetësuesi.



Një prezantues i bizneseve propozoi rritjen e shpejtë të numrit të hipotekave falë një marrëveshjeje “win-win”: investitorët mund të hyjnë lehtësisht në biznesin tim nëse unë i mbyll sytë ndaj kushteve të pranueshmërisë dhe paguaj pak më shumë për të shtuar të ardhurat e tij.

Çfarë duhet të bëj?

Çfarëdo të jenë mundësitë e supozuara të biznesit në lojë, është e ndaluar të pranohet kjo formë e kërkesës. Informoni menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtuëshmërisë për t’i dhënë fund marrëdhënies me këtë ndërmjetësues.



Sikur të fitoja thirrjen për tenderë të këtij Menaxheri të Pasurisë! Unë do t’i arrija objektivat e mia shumë shpejtë. Në fakt, procesi i parapërzgjedhjes organizohet nga një konsulent i jashtëm që unë e njoh shumë mirë: ai ka një ndikim real në treg! Pa dyshim se ai mund të më jepte një ndihmë: a nuk duhet t’i ofroj atij një mandat të ardhshëm për ti mbledhur të gjitha shanset në favorin tim?

A më lejohet të bëj këtë?

Jo, ju duhet të respektoni rreptësisht thirrjen për tenderë të politikave të Menaxherit të Pasurive dhe të BNP Paribas, pa premtuar një mandat të ri për të marrë informata konfidenciale.



Nëse unë mbështes këtë ndarje të njësisë së Menaxherit të Pasurive në komitetin e ardhshëm të pranimit, me siguri që do mund t’i kërkoj në këmbim të më prezantojë me një ndërmjetësues për investimin në prona të paluajtshme me një çmim të ulët tregu... Dhe unë do t’i arrij objektivat e mia!

A është e lejuar?

Jo, ju nuk mund të keqpërdorni pushtetin tuaj të vendimmarrjes në këmbim të një avantazhi të paligjshëm, qoftë edhe për arritjen e objektivave tuaja profesionale.

PALËT E TJERA TË TRETA



Klienti im po eksploron një mundësi të tregut të ri për eksport. Ai duhet të mbështetet te një agjent jashtë shtetit, i prezantuar mirë në vend për të negociuar dhe për të fituar një kontratë të madhe të shitjes së pajisjeve.

A ka nevojë të bëj diçka?

Kini kujdes: prania e ndërmjetësuesve është një burim rreziku dhe kërkon kujdes të shtuar. Kontaktoni menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtueshmërisë për të vazhduar.



Përderisa ankandet e makinave po afrohen, një blerës më propozon një marrëveshje fitimprurëse “win-win”: imponimi i çmimit të tyre referencë dhe marrja e një komisioni për çdo grup të fituar!



Një distributor sugjeroi t’i drejtoja klientët e mi në kompaninë e tij, në këmbim të një ryshfeti.

Si duhet të reagoj?

Në cilindo rast, ju duhet të refuzoni dhe të njoftoni menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtueshmërisë për të vlerësuar integritetin e këtyre blerësve.

Ilustrimet e mësipërme tregojnë gamën e gjerë të situatave në rrezik korrupsioni me të cilat mund të përballet Grupi BNP Paribas.

Keni dyshime? Ju lutem kontaktoni menaxherin tuaj të linjës dhe zyrën e Pajtueshmërisë.



BNP PARIBAS

The bank
for a changing
world